

dokument pune

**STRATEGJIA TERRITORIALE DHE ANALIZA E TERRITORIT PËR
BASHKINË E SHIJAKUT**

skicë jo për reference/ version i dytë

Studio D – development & dialogue

Tetor 2015 – Janar 2016

Ky publikim është përgatitur nga Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp), me mbështetjen financiare të Agjencisë Zvicerrane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Përgatitur nga:

Admir Duraj
Flamur Kuci
Albora Kacani
Prof. Dr. Tatjana Dishnica
Prof. Dr. Arlinda Ymeraj
Rudina I. Hoxha
Zenulla Mehmeti
Ervis Xhafa
Jonida Goga
Enxhi Ndini

Studio D – Development & Dialogue, Janar 2016

Mbështetur nga:

Valbona Karakaçi, Elvin Hoxha

Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp)
HELVETAS Swiss Intercooperation, Shkodër, Albania

Ky publikim reflekton mendimet e autorëve dhe jo detyrimisht të SDC.

Publikuar nga:

Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp)
HELVETAS Swiss Intercooperation (HSI) Albania
Rr. Oso Kuka, Nr. 11,
4000 Shkodër, Albania
www.dldp.al



Funded by



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confederation suisse
Conderazione Svizzera
Confederaziun svicra

Swiss Agency for Development
And Cooperation SDC



HELVETAS
Swiss Intercooperation

ALBANIA

Përmbatja

VOLUMI I: STRATEGJIA TERRITORIALE

Hyrje

Kapitulli 1: Parashikimet e detyrueshme që rrjedhin nga PPK, PKS, PSNQ

1.1. Projektet e nivelit Rajonal

1.2. Projekte ne nivel vendor

Kapitulli 2: Analiza metabolike

Kapitulli 3: Ndarja e territorit sipas sistemeve bazë

Kapitulli 4: Drejtimet e zhvillimit të territorit në bazë të treguesve të sistemeve

Kapitulli 5: Vizioni i zhvillimit të territorit të njësisë vendore

Kapitulli 6: Objektivat strategjike për zhvillimin e territorit

Kapitulli 7: Programet dhe projektet kryesore të zhvillimit

Kapitulli 8: Plani i veprimeve (plani i investimeve kapitale)

Kapitulli 9: Hartat që paraqesin vizionin strategjik të zhvillimit të territorit

Kapitulli 10: Harta e sistemeve ekzistuese së bashku me treguesit përkatës

VOLUMI II: ANALIZA DHE VLERËSIMI I TERRITORIT

Kapitulli 1: Analiza e përgjithshme të gjendjes ekzistuese të territorit

1.1. Të dhëna të përgjithshme

1.2. Temperatura e ajrit

1.3. Mjegulla

1.4. Rreshjet Atmosferike

1.5. Lageshtia e ajrit

1.6. Ecuria e lageshires relative gjate vitit

1.7. Era

1.8. Stuhite

1.9. Lumi Erzen

1.10. Karakteristikat gjeologo-inxhinierike te zones

1.11. Ndertimi gjeologjik

1.12. Hidrogjeologjia

1.13. Rreshqitjet

1.14. Zonimi litologjik i shkembinjve

1.15. Klasifikimi gjeoteknik i shkembinjve

Kapitulli 2: Analiza e dokumenteve të planifikimit të hartuara më parë

Kapitulli 3: Analiza mjedisore

3.1. Të dhëna të përgjithshme

3.2. Te dhenat fiziko-gjeografike dhe klimaterike

3.3. Pastrimi dhe grumbullimi I mbeturinave urbane

3.4. Cilesia e peisazhit dhe mjedisi natyror

3.5. Ligjet kryesore mjedisore

Kapitulli 4: Analiza e problematikës mjedisore

- 4.1. Ajri
- 4.2. Ujrat
- 4.3. Zhurmat
- 4.4. Mbetjet
- 4.5. Biodiversiteti

Kapitulli 5: Zhvillimi Rajonal

- 5.1. Pozicioni i bashkise shijak ne kontekstin rajonal

Kapitulli 6 : Zhvillimi ekonomik

- 6.1. Vështrim i përgjithshëm mbi zonën e Shijakut
- 6.2. Situata e sektorit bujqësor
- 6.3. Analiza SWOT për zonën e studimit

Kapitulli 7 : Analiza dhe vlerësimi i problematikave sociale

Kapitulli 8 : Analiza e zhvillimit social, punësimin, edukimin, shëndetin etj.

- 8.1. Sipërmarrjet
- 8.2. Kostoja mesatare e njesive te banimit
- 8.3. Analiza e te ardhurave dhe zhpenzimeve
- 8.4. Arsimi
- 8.5. Sherbimi shendetsor
- 8.6. Punesimi dhe burimet njerezore

Kapitulli 9 : Demografia

- 9.1. Popullsia

Kapitulli 10 : Strehimi

Kapitulli 11 : Infrastruktura

- 11.1. Infrastruktura, sherbimet dhe transporti
- 11.2. Rrjeti i kanalizimeve te Bashkise Shijak.
- 11.3. Infrastruktura rrugore
- 11.4. Transporti publik

Kapitulli 12 : Analiza e pronave publike

Kapitulli 13 : Analiza e marrëdhënieve të pronësisë mbi tokën

Kapitulli 14 : Çështjet, zonat dhe/ose objektet e rëndësisë kombëtare

Kapitulli 15 : Analiza e elementeve të rëndësishme territorial

Kapitulli 16 : Analiza e elementeve përjashtues

- 16.1. Aktiviteti sizmik në bashkine shijak
- 16.2. Rreziku sizmik për Bashkise Shijak
- 16.3. Vulnerabiliteti i veprave të ndërtimit ekzistuese

Kapitulli 17 : Analiza e përdorimit ekzistues të tokës

Kapitulli 18 : Analiza e periferialitetit

Kapitulli 19 : Analiza e kushteve dhe cilësisë fizike të strukturave e të territoreve

Kapitulli 20 : Analiza e tipologjisë hapësinore ekzistuese

STRATEGJIA TERRITORIALE

Hyrje

Për banorët e Bashkisë Shijak, të vendosur në qytetin e Shijakut dhe në njësitë administrative Xhafëzotaj, Maminas dhe Gjepalaj është mëse e qartë se rritja e mirëqënies mbart me vete jo vetëm mundësi por edhe sfida. Prosperiteti ekonomik i pritshëm nga një zhvillim i mëtejshëm i zonës Tiranë – Durrës duhet të rezultojë në mundësi punësimi dhe investime të reja. Por nga ana tjetër kjo rritje imponon edhe një trysni më të lartë në territorin e bashkisë për t’u përgjigjur me infrastrukturë të përmirësuar dhe shërbime të reja. Për ta administruar rritjen në mënyrë të qëndrueshme bashkia duhet të balancojë ecjen, vendndodhjen, zgjerimin dhe formën e zhvillimit në mënyrë të tillë që të ndikojë pozitivisht në cilësinë e jetës së të gjithë banorëve.

Vërjetet e rëndësishme të përfutuara nga konsultimet me banorë dhe aktorë të ndryshëm lokalë na tregojnë se banorët duan një bashki që mbështet lagje të shëndetshme, mbron dhe përmirëson sistemet mjedisore dhe ruan një ekonomi të larmishme dhe të fortë. Banorët në të gjithë territorin e Bashkisë Shijak sot, vlerësojnë cilësitë dhe karakterin unik të lagjeve, fshatrave, rrugëve dhe vendeve të ndryshme të bashkisë dhe rolin e rëndësishëm që luan trashigimia historike e qytetit në ruajtjen e lidhjes me vendin dhe mbrojtjen e identitetit.

Kapitulli 1: Parashikimet e detyrueshme që rrjedhin nga PPK, PKS, PSNQ

Rajoni Durrës- Tiranë është nyja kryesore e ndërveprimit të burimeve njerëzore, mallrave, dhe hapësirave të jetueshme të veriut dhe jugut të Shqipërisë si dhe porta hyrëse e “Korridorit 8”. Ndikim të drejtpërdrejtë në ekonominë e rajonit, dhe rrjedhimisht edhe në shërbimet, tregun dhe cilësinë e jetës të banorëve të Bashkisë Shijak, luajnë dhe portat logjistike të pozicionuara në këtë rajon, Porti Durrësit dhe Aeroporti “Nënë Tereza”. Rajoni “Durrës –Tiranë” është kontribuesi kryesor i zhvillimit ekonomik në nivel kombëtar, si në numër sipërmarrjesh, po njësoj dhe në shumëllojshmërinë e tyre; kjo falë prezencës së lartë në numër të institucioneve, të dendësisë së lartë të banorëve në rajon si dhe pozicionimit të favorshëm gjeografik.

Për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik dhe një hap cilësor në ekonomi, plani kombëtar i zhvillimit përcakton zonat përkatëse të zhvillimit. Plan i Përgjithshëm Kombëtar parashikon përqendrimin e investimeve në 11 pole ekonomike. Poli Kashar-Vorë do të jetë i karakterizuar nga investimet në industrinë e lehtë, shërbime dhe “showroom”. Poli Vorë – Maminas (Shijak) në logjistikë dhe materiale ndërtimi, ndërsa ai Kamëz-Nikël në përpunim druri. Poli ekonomik i Fushë-Krujës do të karakterizohet nga investimet në logjistikë, agro-industri dhe materiale ndërtimi. Ndërsa ai i Kinostudios, si pol më vete zhvillimi, do t’i përkasë industrisë kreative, medias dhe dizajnit. Një pol më vete parashikohet ai Aeroport-Vorë me fokus të veçantë qendër biznesi, hoteleri, shërbime aeroporti dhe logjistikë. Poli Kashar-Kombinat do të veçohet për industrinë e lehtë dhe hapësirat e magazinimit. Durrës-Shkozë për shërbime portuale logjistike dhe magazinim, ndërsa poli Durrës-Sukth/Shijak do të karakterizohet nga agroindustria dhe logjistika.

Spitalla në Durrës është përcaktuar si zonë ekonomike industriale, ndërsa Kavaja do të karakterizohet nga industria e lehtë dhe agroindustria.

Si rrjedhojë e shndërrimit të rajonit Tiranë-Durrës në një hapësirë të mirëfilltë ekonomike, parashikohet rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto të rajonit me 10%, uljen e papunësisë tek të rinjtë me 5% dhe uljen e papunësisë së përgjithshme me 8%. Rritja e investimeve në teknologji përgjatë këtij rajoni parashikohen të rriten me 10%. Në rajonin Tiranë-Durrës parashikohet gjithashtu hapja e katër inkubatorëve të zhvillimit ekonomik.

Qeveria Shqiptare dhe Ministria e Zhvillimit Urban kanë identifikuar zonën Tiranë-Durrës, si një ndër hapësirat më të rëndësishme ekonomike për vendin si dhe rajonin e ballkanit perëndimor. Për të garantuar një zhvillim të qëndrueshëm territorial dhe urban të kësaj zone, Ministria e Zhvillimit Urban në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit kanë ndërmarrë nismën për hartimin e Planit të Integruar Ndërsektorial për zonën Ekonomike Tiranë-Durrës. Ky plan i përgjigjet sfidave dhe është përcaktuar si ndërsektorial dhe i integruar.


Tre skenarë zhvillimi /Autostrada Tiranë-Durrës, zonë ekonomike

Për zhvillimin e territorit në rajonin Tiranë-Durrës janë zhvilluar tre skenarë, ndërsa vetëm njëri prej tyre do të miratohet nga Këshilli Kombëtar i Territorit për zhvillimin e zonës.

- ÷ Skenari i parë është ai centrik që sheh nevojën për ofrimin e një infrastrukture rrugore me lëvizshmëri më të shpejtë dhe kërkon të lejojë që ndërveprimi ekonomik në “autostradën” Tiranë-Durrës të vijojë më tej. Si rrjedhojë parashikohet zgjerimi i rrugës inter-urbane sekondare dhe kthimi i tij në një aks të lëvizshmërisë së shpejtë. Ndërkohë në pjesën lindore të qytetit të Tiranës plotësohet rrjeti unazor i cili do të lejonte kalimin më të shpejtë veri-jug dhe lindje-perëndim. “Autostrada” Tiranë-Durrës kthehet në një zonë ekonomike të mirëfilltë. Tiranës i jepet prioritet si qendër e rëndësishme për zhvillimin e gjithë rajonit, dhe infrastruktura zhvillohet në funksion të saj.
- ÷ Skenari i dytë, ka në qendër të tij zgjerimin e “Autostradës” Tiranë-Durrës, si një mundësi e mirë për të përmirësuar shpejtësinë e lëvizjes në rajon. Gjithashtu, rruga Tiranë-Ndroq-Durrës kthehet në një hapësirë për rekreacion. Prioritet i jepet edhe ri-zhvillimit të ish-zonave industriale. Rajoni merr një zhvillim ekonomik kryesisht të fokusuar në logjistikë dhe në lëvizjen, tranzitin dhe përpunimin e mallrave.
- ÷ Skenari i tretë ka në thelbin e tij rritjen e rolit të qendrave dytësore si Vorë, Shijak dhe Sukth në ekonominë dhe banimin e rajonit. Synohen investime në infrastrukturë për zgjerimin e pjesshëm të autostradës Tiranë-Durrës, përkatësisht segmenti Vorë-Shijak, zgjerimi i aksit Fushë Krujë-Vorë dhe krijimi i rrjeteve unazore për të dy qytetet kryesore.
- ÷ Polet ekonomike:
 - i. *Poli Kashar - Vorë* Shërbime, Industri e lehtë, Showroom;
 - ii. ***Poli Vorë-Mamínas*** Logjistikë, Materiale Ndërtimi;
 - iii. *Poli Kamëz-Nikël* Përpunimi i Drurit;
 - iv. *Poli Fushë-Krujë* Logjistikë, Agro-industri, Materiale Ndërtimi;
 - v. *Poli Kinostudio* Industritë Kreative, Media, Dizajn Grafik;

- vi. Aeroport-Vorë Qendra Biznesi, Qendër Panairesh, Hoteleri, Shërbime Aeroporti, Logjistikë;
- vii. Kashar-Kombinat Industri e Lehtë, Hapësira Magazinimi;
- viii. **Durrës-Shkozë** Shërbime Portuale, Logjistikë, Magazinim;
- ix. **Durrës- Sukth/Shijak** Agro-industri, Logjistikë;
- x. **Spitalë** Zonë Ekonomike Industriale;
- xi. **Kavajë** Logjistikë, Agroindustri, Industri e lehtë;

Projektet e nivelit Rajonal




Ne kete figure na tregohet analiza e infrastruktures, ekonomise dhe e perdorimit te tokes ne aksin rajonal Tirane-Durres ku Bashkia Shijak administron nje pjese te territorit.

Projekte ne nivel vendor

Bashkengjitur jane planshetat e Planeve Rregullues te perpiluara ne vitet 1976-78, si pjese e dokumentacionit ekzistues per bashkine. Keto plane, qe nuk arriten te realizohen, si rezultat i ndryshimeve ne sistemin politik pas viteve 90, megjithese kane tendenca rregullatore dhe synojne disiplimin e lagjeve te banimit ekzistues, ngelen gjithsesi produkt i nje mendesie te kufizuar, qe i pershtatej kohes dhe koncepteve te saj mbi zhvillimin, ndertimin dhe jeten social-ekonomike.

Projektet kane qene ne nivel "Projekt Ideje", te shoqeruar me prerje te rrugeve te planifikuara dhe informacione te shkruara ne lidhje me rregulloret paraprake dhe kushtet e realizimit te planit. Eshte per t'u vleresuar skema e qarte dhe e paster ne pershtatje me te cilen eshte menduar sistemimi i njesive te banimit, me nje strukture te rregullt, por qe i pershtatet gjithsesi terrenit dhe sistemit rrugor.



Sigurisht sfida me e madhe sot, eshte pershtatja ndaj zhvillimit dhe ecurise intuitive qe paraqet aktualisht e gjithë Bashkia, larg ketyre skemave urbane. Ndertimet e reja jane bere ne mungese te planeve te qarta, duke iu pershtatur pronesise, mundesive te lidhjes me infrastrukturen dhe afersise me arteriet e komunikimit.

Kapitulli 2: Analiza metabolike

Metoda e analizës së metabolizmit urban na ofron një kornizë për analizimin e proceseve teknike dhe socio-ekonomike që ndodhin në qytete. Kjo përfshin vlerësimin e inpute, rezultateve, dhe rezervave të energjisë, ujit, dhe burimeve në një zone urbane. Koncepti është i bazuar në analogji me metabolizmin e organizmave të gjallë, pra edhe qytetet mund të transformojnë lëndë të para në infrastrukturë, biomasë njerëzore, dhe mbeturina.

Migrimi fshat-qytet paraqitet me ndikime dhe efekte ekstreme. Rezultat i tij është hipërburbanizimi i pjesës qendrore të vendit, veçanërisht në zonën Tiranë-Durrës, në të cilën sipas prognozave të ndryshme deri në vitin 2015 parashikohet që të përqendrohet mbi gjysma e gjithë popullsisë së vendit. Ndërkohë që nga rajonet periferike, një pjesë e të cilëve kanë humbur tashmë deri mbi 40% të popullsisë së tyre, parashikohet të vazhdojë edhe më tej largimi i popullsisë. Në tërësi mund të thuhet se procesi i migrimit do të vazhdojë të luaj një rol përcaktues jo vetëm në zhvillimet demografike të vendit, por edhe në ato rajonale dhe lokale. Në këto kushte, është e domosdoshme që në të gjitha rastet e hartimit të planeve dhe strategjive të zhvillimit, të mbahen parasysh zhvillimet e popullsisë në tërësi dhe veçanërisht ndikimi i migrimit në to.

- Pozicioni gjeografik dhe kushtet klimatike të i zonës në studim

Zona në studim pozicionohet pothuajse në mes, të aksit që lidh Kryeqytetin me Durrësin, dy metropolet e vendit. Pikërisht në këtë aks, është edhe përqendrimi më i madh i popullsisë (turizmi veror), c'ka do të thotë që ajo përfaqëson , zonën me kërkesa më të mëdha për produkte bujqësore dhe blegtorale.

Klima e zonës në studim është mjaft e favorshme dhe krijon kushte optimale për prodhimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale.(Detajet për kushtet klimatike, paraqiten në studim);

- Territori, sipërfaqja e punueshme dhe cilësia e tokave

Kjo zonë, kryesisht zonë fushore, ka një shtrirje të madhe. Por, duhet thënë se, sipërfaqja e lënë djerrë për zonën në studim është afërsisht 600 Ha, gati 50% e sipërfaqes së punueshme. (Arsyet e kësaj situate shpjegohen në studim).

Dhe ky fenomen negativ është prezent , kur kjo zone, disponon toka, qe nga pikëpamja e pjellorisë, konsiderohen me pjellori natyrale , mjaft të pasura me elemente ushqyes dhe me horizont të thellë të pjesës aktive. Përsa i përket përbërjes mekanike ato varrojnë nga toka të lehta, të mesme e deri toka të rënda;

- Shpërndarja demografike dhe përbërja e popullsisë

Sic shpjegohet edhe në studim, zona e studiuar është e përbërë nga tre komuna dhe Bashkia e Shijakut. Vihet re që në këtë zonë përqendrimi më i madh i popullsisë është në zonat rurale (komunat e zonës në studim). Popullsia mund të konsiderohet e re, në këndvështrimin e mesatares kombëtare. Nga studimi rezulton që, kryesisht moshë e re ka pak interes për punën në bujqësi, gjë që sjell reduktim të forcave të punës dhe kontributit të tyre. Pra, politikat mbështetëse të qeverisë për sektorin dhe kushtet e reja me marrjen e fondeve të BE, mund të nxisin e motivojnë moshën e re për tu angazhuar sërish në bujqësi.

Me potencialin dhe shtrirjen e zonës, nuk përjashtohet edhe mundësia e angazhimit të krahut të punës edhe nga zonat e tjera përreth. Një fenomen tjetër me impakt mjaft pozitiv për zhvillimin e sektorit , duket të jetë, kthimi nga emigracioni i familjeve të zonës, me fokus kryesor investimin në bujqësi, duke vënë në zbatim eksperiencat të marra nga vëndet ku ata kanë emigruar.

- Potencialet e zhvillimit

Aktualisht, sic mund të shikohet edhe në studimin e kësaj zone, industria agropërpunuese nuk është në nivele të kënaqshme. Për më tepër, ajo është e përqendruar kryesisht në përpunimin e qumështit dhe rrushit. Megjithatë duke marrë në konsideratë numrin e fermave dhe shumëllojshmërinë e produkteve të prodhuara, kjo zonë ka një mospërputhje të madhe të potencialeve prodhuese me ato përpunuese. Zhvillimi i industrisë përpunuese, do të sillte rritje të vlerës së produkteve, rritje e shoqëruar kjo, me zhvillim të zonës dhe rritje të punësimit.

Gjatë studimit, është vënë re që, pavarësisht potencialeve, zona në studim ka shumë probleme që lidhen me sektorin. Më poshtë në mënyrë të përmblendhur paraqiten gjetjet dhe rekomandimet. (te cituara ne pjesën e fundit te studimit)

- Mungesa e informacionit bujqësor kryesisht për:

- i) teknologji kultivimi,

- ii) mbrojtja e bimëve,
 - iii) të dhënat për tregjet ku përfshihen, çmime, kërkesë ofertë,
 - iv) asistenca e duhur në përdorimin e inputeve, teknologji ruajtje dhe përpunimi etj
- Mungesa e prezencës së strukturave përgjegjëse shtetërore në sigurimin e funksionimit të infrastrukturës së kullim ujitjes.
 - Mungesa e subvencionimeve (sidomos dy vjecarin e fundit)
 - Mungesa e tregjeve, mosfunksionimi i tyre (Xhafzotaj) apo infrastruktura e dobët kur ato funksionojnë (Shijak).
 - Rritja e kostove për shkak të transportit në tregjet jashtë zonës së studimit, si edhe cilësia e dobët e ofruesve të këtij shërbimi.
 - Indiferenca e njësive vendore të qeverisjes kundrejt sektorit. Njësitë vendore nuk përfaqësojnë fermerët në nivelet e qeverisjes qendrore. Momentalisht reforma territoriale duke ndryshuar organizimin e komunave nga njëra anë ul ndikimin e njësive vendore në rajon por nga ana tjetër bashkimi në një njësi vendore mund të sjellë një koordinim më të mirë dhe adresim e zgjidhje më të mirë të problemeve si psh vënia në efencë e tregjeve, përmirësimi i infrastrukturës rrugore etj.
 - Shfrytëzim në nivel të ulët i burimeve natyrore (toka), zhvillim i ulët i industrisë përpunuese dhe sektorit të shërbimeve si agroturizmi.

Kapitulli 3: Ndarja e territorit sipas sistemeve bazë

Shijaku është **pjesë përbërëse e rajonit ekonomik Tiranë – Durrës**. Ndaj mund të presë një zhvillim ekonomik të rendësishëm nga ky rajon përse i përket investimeve dhe shërbimeve.

Projekte zhvillimi dhe përmirësimi të infrastrukturës rajonale janë ndihmesë e veçantë në zhvillimin dhe qeverisjen e territorit.

Shijaku ka afërsi me tregjet të rendësishme si Durrësi dhe Tirana.

Shijaku përfshihet në përparësitë e Qeverisë Shqiptare për zhvillimin e **rajonit ekonomik Tiranë-Durrës**.

Territori ofron kushte të favorshme për zhvillimin e agro-turizmit (afërsi me plazhe, terreni kodrinor i butë, prodhime bujqesore e blektorale cilësore etj), gjë që ndihmon në **krijimin e aktiviteteve që do të gjenërojnë vende pune dhe do të kontribuojnë në reduktimin e varfërisë**.

Shijaku karakterizohet nga një mikroklimë shumë e përshtatshme për rritjen dhe zhvillimit normal të një numri të gjërë kulturash me produktivitet dhe fitim të lartë.

Ndërhyrja në territor mund të ketë një ose më shumë nga qëllimet e mëposhtme.

- ÷ **Konsolidimi:** Në disa zona të mirëorganizuara, modeli ekzistues i zhvillimit duhet vetëm të konsolidohet. Qëllimi është të përmirësohen këto zona, sipas nevojave, nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës (rrugë, shërbime, shërbime publike, etj) dhe të forcohen karakteristikat ekzistuese. Ndërtimet e reja dhe rehabilitimet, ku përfshihen shtesat dhe zgjerimet në objektet ekzistuese, janë të lejueshme. Synohet konsolidimi i modeleve të përdorimit të tokës në vendbanime të organizuara

relativisht mirë dhe të parandalohen ndërtimet e reja që ndryshojnë shumë nga strukturat ekzistuese në secilën zonë.

- ÷ **Ruajtja:** Konservimi i strukturave me vlerë dhe atyre historike të indit urban është një qëllim i rëndësishëm për disa zona të Komunës. Këto struktura do të vlerësohen nëpërmjet Planeve të Detajuara Vendore. Qëllimi kryesor është nxjerrja në pah e vlerave estetike dhe historike të disa zonave që mund të kenë impakt pozitiv në zhvillimet e ardhshme.
- ÷ **Sistemimi:** Sistemimi ka vlerë kryesisht për zonat qendrore të fshatrave të komunës, të cilat janë transformuar gjatë viteve të fundit si pasojë e procesit jokoherent të zhvillimit urban. Në këto territore sot gjendet një përzierje formash (arkitekturë tradicionale, godina të reja informale, arkitekturë bashkekohore etj) të cilat janë shumë të ndryshme dhe nuk ndjekin asnjë rregull. Në këto territore vihet re një mungesë rrjeti rrugor dhe hapësirash publike. Qëllimi për këto zona është që të mbështeten aktorët lokalë për të manaxhuar situatën duke kryer përmirësimet me kalimin e kohës - nëpërmjet një ndërhyrje minimale nga sektori publik.
- ÷ **Krijimi:** Kjo ndërhyrje synohet në zonat që aktualisht janë pak të zhvilluara, të pazhvilluara apo në ish-territore bujqësore sot të përfshira në zona informale. Qëllimi është që nëpërmjet një procesi koherent planifikimi të promovohen zhvillimet e reja.
- ÷ **Rinovimi:** Disa ish zona/objekte jo funksionale apo ish zonat e reparteve ushtarake duhet të rinovohen dhe të hapen ndaj përdorimeve të reja. Qëllimi është nxitja e zhvillimit të zonës dhe nëpërmjet bashkëpunimit me sektorin privat. Procesi duhet të programohet në mënyrë të posaçme për secilin rast, duke marrë parasysh potencialet e disponueshme, prirjet e zhvillimit dhe interesat e sektorit privat.
- ÷ **Mbrojtja:** Zonat e mbrojtura nënkuptojnë kufizimin e zhvillimit për një periudhë të caktuar apo edhe përgjithmonë. Qëllimi është kufizimi i zhvillimit në zona të caktuara, të karakterizuara si “të brishta”, për të mbrojtur vlerat natyrore dhe kulturore: parqet, zonat e gjelbra, zonat me ndjeshmëri ekologjike, zonat bujqësore, etj. Po të jetë e nevojshme do të bëhet vlerësimi dhe rialokimi i strukturave/banorëve ekzistues, ndërkohë që do të ndalohen ndërtimet e reja.
- ÷ **Rezervimi/Ngrirja:** Në territoret e parashikuara për zhvillime të akseve të rëndësishme të infrastrukturës rrugore e inxhinierike, në territoret e dedikuara për ndërtimin e impianteve në shërbim të rrjeteve inxhinierike apo për infrastrukturë sociale dhe shoqërore parashikohet ndalimi i zhvillimit. Në këto zona po të jetë e nevojshme do të bëhet vlerësimi dhe rialokimi i strukturave/banorëve ekzistues.

Kapitulli 4: Drejtimit e zhvillimit të territorit në bazë të treguesve të sistemeve

- ÷ Sisteme mjedisore të vlerësuara
- ÷ Lagje dhe vendbanime të plotësuara dhe dinamike
- ÷ Ekonomi e fortë dhe e larmishme
- ÷ Arkitekturë urbane cilësore

Kapitulli 5: Vizioni i zhvillimit të territorit të njësisë vendore

Zhvillimi i ardhshëm i bashkisë së Shijakut, është i lidhur si me shumë alternativa dhe shanse, ashtu edhe me rreziqe dhe vështirësi të ndryshme. Para së gjithash, është e nevojshme që të krijohet një vizion i qartë mbi të cilin duhet të mbështet zhvillimi i ardhshëm i zonës. Kjo kërkon paraprakisht sqarimin dhe zgjidhjen e shumë problemeve të sotme, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me legalizimin apo prishjen e ndërtimeve ilegale, sqarimin dhe zgjidhjen e problemit të pronësisë mbi tokën, përmirësimet e infrastructures më të domosdoshme (rrugë, ujë, energji), ngritjen e funksionimit e objekteve të infrastrukturës sociale (kopshte fëmijësh, shkolla, qendra shëndetsore), mbrojtjen dhe kontrollin e cilësisë së mjedisit etj. Zgjidhja sa më e shpejtë e problemeve të tilla, do të hapte rrugën për hartimin dhe realizimin e strategjive, koncepteve dhe masave të një zhvillimi të qëndrueshëm të rajonit. Njëkohësisht me këtë, do të jetë e domosdoshme përcaktimi i detyrave dhe marrja përsipër e realizimit të tyre nga personat dhe institucionet përgjegjëse, si dhe organizimi i një kontrolli të vazhdueshëm rreth realizimit të objektivave të vendosura. Në këtë kuptim është veçanërisht e rëndësishme përcaktimi i kompetencave dhe marrja përsipër e përgjegjësisë midis niveleve kombëtare dhe lokale të administrimit dhe menaxhimit të resurseve natyrore dhe humane.

Si pjesë e konsultimit me banorë dhe aktorë të ndryshëm vendorë, ekipi hartues i kësaj analize ka konkluduar me versionin e mëposhtëm të vizionit të Bashkisë Shijak:

Shijaku është një bashki me burime të pasura njerëzore, natyrore dhe potencial ekonomik që, nën drejtimin e një qeverisjeje vendore efektive, synon rritjen e mirëqënies së banorëve të saj nëpërmjet një ekonomie funksionale shërbimesh dhe agroturizmi, bujqësie organike dhe intensive dhe një industrie që ndihmon fuqizimin e biznesit, mbështetur në një infrastrukturë moderne dhe të kompletuar, gjithmonë në harmoni me mjedisin.

Kapitulli 6: Objektivat strategjike për zhvillimin e territorit

- ÷ Të ruajmë, mbrojmë dhe përmirësojmë mjedisin natyror të territorit të Bashkisë – lumin Erzen, liqenet, bazenet, pyjet dhe përrenjtë – për vetë funksionin e tyre ekologjik, vlerat ekonomike dhe estetike që kanë.
- ÷ Të planifikojmë, ndërtojmë dhe restaurojmë lagje të aksesueshme me strukturë, shërbime dhe lehtësira efikente, që përmbajnë edhe opsione të ndryshme strehimi.
- ÷ Të vijojmë punën për ta fuqizuar rolin e qytetit si qendër tregtie dhe punësimi në zonën e Shqipërisë së mesme në përputhje me direktivat kombëtare të zhvillimit ekonomik.
- ÷ Të punojmë intensivisht për përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve përmes ekselencës në arkitekturën urbane të ndërtesave, rrugëve, lagjeve dhe hapësirave publike në të gjithë territorin.

- ÷ Të mbështesim rritjen dhe zhvillimin në të gjithë territorin e bashkisë përmes një rrjeti transporti eficient dhe efektiv, dhe investimeve në infrastrukturën e furnizimit me ujë dhe rregullimit të ujrave të zeza.
- ÷ Të promovojmë një model rritjeje dhe përdorim të tokës që inkurajon zhvillim të ligjshëm, eficient dhe të padëmshëm në mjedis.
- ÷ Të garantojmë që rritja në territorin e bashkisë gjatë periudhës që mbulon kjo strategji, është arritur përmes aplikimit të praktikave eficiente, të arsyeshme në planin financiar dhe mjedisor, si dhe falë angazhimit dhe përfshirjes në vijimësi të banorëve, partnerëve vendor dhe falë bashkëpunimit ndër-institucional dhe rajonal.

Kapitulli 7: Programet dhe projektet kryesore të zhvillimit

Dy janë karakteristikat lokale të cilat janë përgjegjëse për ndryshimin mes zhvillimit të qëndrueshëm dhe zhvillimit të qëndrueshëm lokal: (1) një fluks ndërkufitar i të mirave dhe shërbimeve ekonomike dhe mjedisore; dhe (2) përcaktuesit e jashtëm të zhvillimit lokal. Realizimi i zhvillimit të qëndrueshëm lokal mund të cilësohet si i bazuar në sigurimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore në rajon dhe të importit dhe eksportit të qëndrueshëm - nga pikëpamja e zhvillimit të qëndrueshëm lokal në njësi të tjera, të burimeve, të mirave, shërbimeve dhe mbetjeve.

Programe të identifikuar, ende në diskutim me aktorë vendorë:

- ÷ Fuqizimi i rritjes ekonomike, tregut të punës dhe punësimit;
- ÷ Promovimi i barazisë në qasjen dhe shpërndarjen e shërbimeve, përfshirje sociale dhe në rigjenerim të zonave të ndryshme brenda territorit të bashkisë;
- ÷ Mbrojtje dhe përmirësim të mjedisit urban, duke përfshirë menaxhim të qëndrueshëm të transportit dhe energjisë;
- ÷ Përmirësim të qeverisjes vendore përmes fuqizimit të pjesëmarrjes së banorëve në vendimarrje dhe zhvillim të kapaciteteve të administratës publike lokale për ta sjellë shtetin më pranë nevojave të çdo komuniteti;

NJESIA ADMINISTRATIVE GJEPALAJ

PROJEKTET	Vlera ne 000/lek
Projekt ndertimi I zyrave te Njesise Administrative Gjepalaj	16,178,642
Ndertimi i shkolles 9 - vjecare Fshati Shtraze	31,880,247
Projekt per mbrojtjen nga zjarri	
Rikonstrukcion, sistemimin e asfaltim I rruges auto Shetel	35,982,497
Rikonstrukcion, sistemimin e asfaltim I rruges auto Cizmeli	43,610,505
Rikonstrukcion, sistemimin e asfaltim I rruges auto Kenete	22,661,411
Projekt I ndertimit te Ujsjelles - Kanalizimeve Lagja Kokomoneve Aardhishte	16,899,307
Projektimi I rruges Bioferma - Qender Likeshe	

Rikonstrukcion I Ujsjellesit Fshatit Eminas I Vogel	13,000,000
Palestra e shkolles 9 - vjecare Hardhishte	16,287,036
Palestra e shkolles 9 - vjecare Gjepalaj	
Projektimi I ndertimit Ujsjellesit te Njesise Administrative Gjepalaj, per Fshaterat Likeshe dhe Hardhishte	39,728,485

NJESIA ADMINISTRATIVE MAMINAS

PROJEKTET	Vlera ne 000/lek
Projekti " Rruga Lagja e Re" Metallaj	35,154,833
Projekti " Lagja e Re " Bodinot	35,840,068
Projekti " Rruga Liqeni Karpinit" Bodinot	36,836,081
Projekti "Rruga Rubjeke" Cinor	37,836,487
Projekti " Rruga e Ushtrise" deri tek Diga Karpinit	
Projekti "Rruga Karrec"	13,377,000
Projekti " Rruga e Varrezave" Vlashje.	4,975,558
Projekti I ndertimit te zyrave te Njesise Administrative Maminas	36,206,801
Projektii Shkolles 2 kateshe Metallje	18,665,580
Projekti I Rruges se Varrezave	4,975,558
Ndertimi I Kanalizimeve e ujrave te zeza Fshati Karrec	5,476,817
Ndertimi I Rrjetit te Shperndarjes te Ujsjellesit nga Depozitat te fshatrat, Bilalas, Rubjek, Bilalas.	62,184,462

NJESIA ADMINISTRATIVE XHAVZOTAJ

PROJEKTET	Vlera ne 000/lek
Qender Shendetesore Sallmonaj	8854839
Shkolla 9 - vjecare Sallmonaj	68116427
Shkolla 9 - vjecare Sallmonaj	
Projekti I KUZ ,lagja sallmone	33000000
Rruga ish SMT, Shijak -Autostrade-Superstrade	

BASHKIA SHIJAK

PROJEKTET	Vlera ne 000/lek
Rikonstrukcion I rruges "16 shtatori"	34,318,565

Reabilitim I Lumit Erzen	193,059,000
Rikonstruksion I Pallatit te Kultures	26455995
Ndertim I Palestres tek shkolla Muharrem Dollaku	14436094

Kapitulli 8: Plani i veprimeve (plani i investimeve kapitale)

Territori vuan nga mungesa e investimeve dhe në disa raste mirëmbajtja e infrastrukturës e shtyrë në kohë. Më konkretisht, shërbimet bashkiake si furnizimi me ujë të pijshëm, kanalizimet, transporti urban dhe mbetjet e ngurta do të duhet të lidhen me reformën institucionale, ligjore dhe rregullatore për të siguruar që bashkia të ketë burime të parashikueshme të ardhurash të pavarura kundrejt të cilave ta ketë të mundur të marrë hua dhe që parimet e nivelit vendor të mbulimit të kostove të respektohen në nivel të shoqërive që kryejnë shërbimet.

Zhvillimi i një linje projektsh të realizueshëm në sektorin e infrastrukturës mjedisore dhe bashkiake do të jetë një objektiv kryesor i Bashkisë gjatë periudhës së mbuluar nga kjo Strategji. Bashkia po shqyrton mundësi të ndryshme financimi për një projekte të zhvillimit të bujësisë, turizmit, mirëmbajtjes së rrugëve dhe shërbimeve sociale në territorin e saj. Mundësi ekzistojnë në sektorin e trajtimit të ujrave të zeza dhe të furnizimit me ujë të pijshëm, ku në mënyrë tipike është i mundshëm mbulimi i kostove përmes një reforme të përshtatshme të tarifave. Edhe investimet për transportin urban dhe për trajtimin e mbetjeve të ngurta do të shqyrtohen si mundësi. Bashkia do të shqyrtojë nmundësinë e krijimit të strukturave të përshtatshme për decentralizimin dhe kthimin e ndërmarrjeve të shërbimeve komunale në shoqëri aksionere. Në një fazë të mëvonshme, në varësi të cilësisë së shoqërive dhe të natyrës së mbështetjes nga autoritetet bashkiake apo qendrore, Bashkia mund të shqyrtojë mundësinë e zgjerimi të aktivitetit të këtyre ndërmarrjeve në kategori dhe hapësira të caktuara në territorin e saj. Bashkia do të vlerësojë aftësinë kredimarrëse të ndërmarrjeve në pronësi të saj dhe do të përcaktojë, duke u mbështetur te ky vlerësim realizueshmërinë e projekteve që i përgjigjen objektivave të kësaj strategjigje dhe njëkohësisht nevojave imediate të banorëve të Shijakut.

Shpenzimet per Projekte kapin shumen 29.986 mije leke dhe zene 9.5 % te Buxhetit të vitit 2016. Keto projekte jane domosdoshmeri per ti paraprire Investimeve per vitet ne vazhdim. Ne menyre analitike keto projekte paraqiten e tabelen në vijim.

Art	EMERTIMI I OBJEKTIT	PLAN 2016
230	PROJEKTE APARATI	
	Projekti i Ndertimit te Bashkise se Re Shijak	2.620
	Projekti i Ndertimit te Pallatit Kultures Shijak	2.243
	Projekti i Ndertimit te Baneses Sociale Shijak	7.760
	Projekti i i Rehabilitimit te Nderteses se Njesise Admin MAMINAS	1.889
	Projekti i i Rehabilitimit te Stadiumit Shijak	1.310
	Supervizione dhe kolaudoatore te objekteve me kontrata te lidhura	2.000
	SHUMA I	17.822

230	PROJEKTE SHERBIMET PUBLIKE	
	Rikualifikim i Hapesirave prane Liqenit Lagje ERZEN	1.890
	SHUMA II	1.890
230	PROJEKTE UJESJELLES	
	SHUMA III	-
230	PROJEKTE RRUGE	
	Projekti i Rehabilitimit te Rreth Rrotullimit 4 Rruget	1.315
	Projekti i Rikonstruksionit Rruges te Fabrika Niseshtes	3.227
	Projekti i Rikonstruksionit Rruges Njesia Ad Gjepalaj(Ardhishte Shijak)	1.557
	Projekti i Rikonstruksionit Rruges te brendshme Lagje Koder Shijak	4.175
	SHUMA IV	10.274
	SHUMA TOTALE	29.986

Kapitulli 9: Hartat që paraqesin vizionin strategjik të zhvillimit të territorit

Kapitulli 10: Harta e sistemeve ekzistuese së bashku me treguesit përkatës

ANALIZA DHE VLERËSIMI I TERRITORIT

Kapitulli 1: Analiza e përgjithshme të gjendjes ekzistuese të territorit

Të dhëna të përgjithshme

I gjithë territori është i hapur ndaj ndikimit të klimes tipike mesdhetare, për të cilën influencën afërsia me detin dhe njekohësisht kalimi i lumit Erzen në të gjithë territorin e kësaj bashkie. Karakterizohet nga një dimer i lageshtë dhe me reshje të shumta dhe një verë e nxehtë dhe e thatë.

Nën efektin e ndryshimeve klimaterike stina e verës është bërë edhe më e nxehtë dhe regjimi i reshjeve gjatë vitit është prishur. Kjo kërkon marrjen e masave për të siguruar mospermbajtjen e disa ndertimeve që janë bërë në afërsi të lumi Erzen në vitet e fundit. Pasurite ujore të këtij rajoni janë të krenaqshme dhe kanë një rëndësi të vecantë në garantimin e jetës sociale dhe ekonomike. Megjithatë ato ndikohen nga reshjet atmosferike.

	Emërtimi	Vlera
1	Temp. Mesatare vjetore	15.1
2	Temp. Mesatare më e lartë në verë °C	29.9
3	Temp. Më e lartë absolute °C	42.2
4	Temp. Mesatare më e ulët në dimër °C	6.7
5	Temp. Më e ulët absolute °C	-10.4
6	Rreshjet mesatare vjetore, mm	1270
7	Rreshjet maksimale vjetore, mm	1770
8	Rreshjet minimale vjetore, mm	773
9	Avullimi mesatar (E.T.P) (E.V) mm	880; 600
10	Drejtimi mbizotërues i erës vjetore	V; P (14.6%)
11	Mbizotërimi i erës në verë	V; P (2-5%)
12	Mbizotërimi i erës në dimër	J; L (17- 5%)
13	Shpejtësia mesatare e erës në m/s	1.8
14	Presioni bazë i erës kg/m ²	0.281
15	Thellësia maksimale e borës në cm	15
16	Thellësia maks. e ngrirjes së tokës në cm	10
17	Lagështia relative mesatare vjetore, %	70
18	Lagështia relative mesatare në verë, %	63
19	Lagështia relative mesatare në dimër, %	73
20	Numri mesatar i ditëve me reshje ≥ 0.1 mm	129
21	Numri mesatar i ditëve me reshje ≤ 0.1 mm	100
22	Numri mesatar i ditëve me reshje ≥ 5 mm	64
23	Numri mesatar i ditëve me reshje ≥ 10 mm	45
24	Zgjatja faktike e djellëzimit në orë, vjetore	2530
25	Magnituda maksimale e pritshme	60-70

Temperatura e ajrit

Temperaturat variojnë në stinën e verës nga 28-35 gradë C dhe në stinën e dimrit deri 5-12 gradë Celcius. Temperatura mesatare vjetore varion nga 15°C deri në 16°C. Temperatura maksimale absolute 41.5°C e regjistruar më 18.07.1973, temperatura minimale absolute arriti -10.4°C më 15.01.1968. Paraprakisht duhet vënë në dukje se gjithë Ultesira Bregdetare (ku ndodhet zona në studim) gjendet nën ndikimin e fuqishëm të detit Adriatik.

Nje nga parametrat e rendesishem te temperatures se ajrit eshte temperatura mesatare e tij. Per te studiuar shperndarjen e ketij elementi ne zone si dhe shperndarjen e tij gjate vitit,ne

Ne tableat e meposhteme jepen temperaturat mesatare te vendmatjes meteorologjike Tirane.

Tepmeratura mesatare mujore dhe vjetore e ajrit.

Muaji	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	vjetore
temp	6.9	7.9	9.9	13.3	17.7	21.6	23.8	23.8	20.6	16.1	11.8	8.2	15.1

Temperatura maksimale absolute

Muaji	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	vjetore
temp	21.3	27.7	29.6	31.7	35.8	37.9	41.5	40.3	37.0	31.4	26.9	22.5	41.5

Temperatura minimale absolute

Muaji	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	vjetore
temp	-10.4	-7.6	-7	0	1.8	5.6	9.4	10.	3.8	-1.3	-6.1	-6.9	-10.4

Numri i diteve me temperature $\leq 0^{\circ}\text{C}$

Muaji	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	vjetore
Nr	10.3	5.5	3.8	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.3	3.4	8.6	32.2

Nga te dhenat e mesiperme vihet re se dite te ftohta ndodhin gjate periudhes se ftohte te vitit (Nentor-Mars) ku me te shquarit jane muajt Dhjetor dhe Janar, ndersa ditet me temperature nen -50°C jane shume te rralla dhe vetem nje dite mund te ndodhe ne muajin Janar.Ne perfundim, persa i perket temperaturave te ajrit duhet thene se zona ne studim karakterizohet nga nje klime e bute mesdhetare.

Mjegulla

Mjegulla eshte ngjarje atmosferike qe veshtireson dukshmerine dhe transportin, sidomos kur ka intensitet te madh dhe ndodh shpesh. Paraprakisht, duhet thene se mjegulla si fenomen atmosferik eshte dukuri e rralle ne Shqiperi. Per pasoje edhe zona ne studim preket shume pak nga kjo dukuri.

Per te analizuar mjegullen do te ndalemi ne dy aspekte, ne numrin e diteve me mjegull dhe kohezgjatjen e saj ne ore. Rezulton se mesatarja vjetore me e madhe eshte 10.5 dite me mjegull ne Tirane-kjo eshte dhe me e madhja ne te gjithe Ultesiren Bregdetare-ku ne Shkoder eshte 6.1 dite dhe ne Vlore 1.5 dite ne vit. Ne pergjithesi ne muajt e stines se veres ne vendmatjen meteorologjike te vendit tone, mjegulla eshte nje dukuri e rralle.


Nga analizat e materialit te ngjarjeve atmosferike te elementit mjegull per te cilet jepet numri i diteve me mjegull, u llogarit edhe koha e zgjatjes se mjegulles. Rezulton se ne te gjithe zonen ne studim mjegulla zhvillohet pas mesit te nates, rreth ores 2 ose 3 dhe vazhdon deri ne oren 9-10 te mengjesit. Por nuk perjashtohen rastet kur mjegulla zhvillohet ne oret e mbremjes. Si rregull, ne muajt e periudhes se ngrohte te vitit, mjegulla zhvillohet rralle dhe ne qofte se ka raste qe zhvillohet nuk zgjat shume kohe.

Rreshjet Atmosferike

Reshjet atmosferike jane nga elementet me te rendesishem klimatik qe percaktojne vecorite klimatike te nje zone.

Muaji	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	vjetore
Nr	135	126	113	102	92	63	38	45	84	111	162	141	1210

Periudhat me me shume rreshje jane vjeshta dhe dimri, ku bien 10-14% te rreshjeve vjetore ndersa periudha me e laget e vitit eshte (Tetor – Maj) qe ze 70 – 80% te rreshjeve vjetore. Ne Nentor vrojtohen rreshjet me te shumta, qe jane deri ne 171mm dhe rreshjet me te pakta vrojtohen ne muajt Korrik-Gusht, respektivisht 41.5mm dhe 47.2 mm. Debora bie rralle.



Faktoret qe ndikojne ne karakteristikat e reshjeve atmosferike jane ne pozicionin gjeografik, afersia me detin dhe topografia. Ne tabelen jepen te dhenat mbi reshjet mujore dhe vjetore. Konkretisht ne zonen ne studim, sasia e reshjeve vjetore eshte rreth 1200mm.

Sasia me e madhe e reshjeve ku jane regjistruar 1770 mm dhe me e vogla 770 mm ne vit. Sikurse tregohet ne garfik shperndarja e reshjeve gjate vitit ka nje forme “U” qe eshte tipike e nje regjimi Mesdhetar rreshjesh. Sasia me e madhe e reshjeve pritet gjate periudhes se ftohte te vitit dhe muajt me te laget jane Nentor-Dhjetor (162 dhe 141mm perkatesisht). Muaji me i thate eshte Korriku (38mm).

Rendesi paraqet edhe shpeshtesia e shfaqjes se reshjeve te vogla si: 0.1 mm, 1.0 mm, 5mm dhe 10 mm. Per kete qellim jane llogaritur per gjithe periudhen me te dhena, numri i diteve me reshje ≥ 0.1 mm, ≥ 1.0 mm, ≥ 5 mm dhe ≥ 10 mm.

Reshjet intensive ne sasi te medha per intervale te ndryshme kohezgjatjeje dhe sidomos per kohezgjatjet e medha, vrojtohen ne situata te caktuara sinoptike dhe sidomos kur ciklonet dhe frontet atmosferike jane stacionare. Ato gjithashtu jane te lidhura me llojin e reve dhe te ndikimeve lokale.

Duke pasur parasysh sasine maksimale per 24 ore te reshjeve dhe intensitetin per interval te ndryshme kohe ne periudha te ndryshme rikthimi (return periods) zona ne studim karakterizohet per intensitete te larte te reshjeve.

Lageshtia e ajrit

Si nje tregues i rendesishem i lageshtires se ajrit, sherben “lageshtia relative” e cila ka nje ndikim te drejtperdrejte ne aktivitetin njerezor. Ne ecurine vjetore te ketij treguesi verehen ndryshime qe jane kushtezuara nga qarkullimi stinor dhe relievi. Te dhenat e rabele tregojne se vlerat me te larta te lageshtires relative te ajrit vrojtohen ne gjysmen e ftohte te vitit, gje qe shpjegohet me veprimtarine ciklonare qe vrojtohet ne zonen e marre ne studim gjate kesaj periudhe te vitit.

Vlerat me te larta i takojne muajve Nentor, Dhjetor dhe Janar. Nderkaq vlerat me te uleta te lageshtires relative vrojtohen ne muajin Korrik dhe Gusht, pikerisht kur mbi rajonet e Mesdheut verehet nje qendrueshmeria anti-ciklonare e theksuar. Ecuria ditore e lageshtires relative eshte e kundert me ate te temperatures se ajrit. Ne oret e para te mengjesit realizohen vlerat me te larta kurse ne oret e mesdites (para ose pas mesdites) vlerat me te uleta.

Ecuria e lageshires relative gjate vitit

Ne zonen ne studim mbizoteron forma qarkullimit perendimor i cili duke u shvendosur nga perendimi ne lindje, sjell me vete masa ajrore te pasura me lageshtire dhe relativisht te ngrohta. Gjithashtu rritja e sasise se reshjeve nga fundi i vjeshtes dhe fillimi i pranveres ben qe lageshtia relative gjate vitit te qendroje ne vlera pothuajse te peraferta. Per kete arsye, zona ne studim ka vlere relativisht te larte te lageshtires eshte relative dhe me ndryshime jo shume te ndjeshme nga muaji ne muaj me tjetrin. Amplituda vjetore midis vleres me te larte 76% dhe asaj me te ulet 61% eshte 15%. Lageshtia mesatare vjetore eshte 70%.

Era

Nje aspekt tjetër i rendesishem eshte edhe vleresimi i karakteristikave te ererave ne zonen ne studim. Ne parametrat kryesor te eres perfshihen te dhenat per drejtimin e saj (shpeshtesia sipas drejtimeve) dhe shpejtesia e saj, po sipas drejtimeve te ndryshme, qe tregohen ne tebelet dhe grafikisht shpjegohen me poshte ne trendafilin e ererave

	V		V.L.		L		J.L.		J		J.P.		P		V.P.A	
Q	r	sh	r	sh	r	sh	r	sh	r	sh	r	sh	r	sh	r	sh
44	3.5	2.7	2.8	2.0	3.4	1.5	15.8	2.5	4.4	2.4	7.4	2.7	3.9	2.5	15.1	2.9

Rastisja mesatare e drejtimit te eres dhe shpejtesia mesatare sipas drejtimeve

(r- rastisja, sh – shpejtesia mesatare ne m/s)

Rajoni karakterizohet nga nje vlere 44% e gjithe vitit me qetesi (nuk ka ere 44% e periudhes vjetore). Shpejtesia mesatare varion nga 2.9m/s ne 1.5m/s ndersa ajo maksimale arrin ne raste te vecanta atmosferike (tufane) deri ne 40 m/s. Rastisjen me te madhe e ka drejtimi I eres Jug-lindje me rastisje ne perqindje 15.8, dhe jug-perendimi me 15.1%.


Muaji	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	vjetore
D/B	1.6	1.8	1.7	1.5	1.5	1.3	1.6	1.5	1.3	1.3	1.3	1.4	1.5

Shpejtesite mesatare te ere m/sekonde

Ne periudhen e dimrit rastisja (ne %) e drejtimit te eres eshte per 20.9% ne pranvere per drejtimin veriperendimor eshte 15.4%, ne vere per drejtimin VP. eshte 20.1% dhe ne vjeshte per drejtimin JL eshte 14.6%.

Shpejtesia e eres ne territorin e zones ne studim, si ne te gjithe vendin tone, eshte ne vartesi te periudhes se vitit. Vlerat me te medha te tyre vrojtohen ne stinen e dimrit kur veprimtaria ciklonare eshte e theksuar.

Trendafilin e ererave



Ne vartesi te levizjeve te sistemeve barike dhe relievit te zones qe studiojme, era peson ndryshime te rendesishme. Te dhenat e deritanishme per shpejtesine e eres percaktojne dhe karakteristikat e vecanta lidhur me forcen e saj. Gjate dites era arrin shpejtesine maksimale sidomos ne oret e mesdites. Kjo lidhet me levizjet vertikale te ajrit sidomos gjate stines se veres. Shpejtesite maksimale arrijne 20 deri 30m/sek.

Ne tebeje jepen te dhenat e rastisjes se eres ne perqindje. Ne kete tebeje shihet se shpejtesite nga (0-1m/sek) mbizoteron ne te gjithe zonen ne studim, mbizoterojne dhe shpejtesite (2-5m/sek) dhe rralle (6-10m/sek). Shpejtesite (11-15m/sek) jane te rralla. Gjate dites era arrin shpejtesine maksimale sidomos ne oret e mesdites. Kjo lidhet me levizjet vertikale te ajrit sidomos gjate stines se veres. Shpejtesite maksimale arrijne 20 deri 30m/sek.

Rastesia e shpejtesise se eres (m/s)

Shpejtesi 0-1 Shpejtesi 2-5 Shpejtesi 6-10 Shpejtesi 11-15 Shpejtesi ≥ 15

59.7 36.1 4.0 124 106

Si erera lokale ne zonen ne studim jane evidentuar brizat detare (puhite).

Stuhite

Stuhite qe per vendin tone jane te shumta dhe ndodhin ne te gjithe stinet e vitit, shpesh shoqerohen me bresher. Me shume dite me bresher ka ne muajt e dimrit dhe gjysmen e vjeshtes dhe ne gjysmen e pare te pranveres.

Numri mesatar i diteve me bresher

Muaji	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	vjetore
Ditët	1.1	1.3	0.9	1.3	0.6	0.3	0.1	0.2	0.3	0.9	1.3	1.0	8

Si rregull, zgjatja e breshrit eshte 3 deri 5 minuta. Ne zonen ne studim, bresheri vrojtohetne cdo kohe te vitit por me shume ne periudhen e ftohte te vitit. Gjate muajit Janar pothuajse vrojtohet mesatarisht nje dite me bresher. Ne periudhen e ngrohte te vitit numrii diteve me bresher eshte i pakët. Stuhite ne zonen ne studim mund te ndodhin ne cdo muaj, kjo tregon karakterin mesdhetar qe ka klima e zones tone. Ne thellesi te territorit te Gadishullit Ballkanik gjateperiudhes se ftohte te vitit (dimrit) stuhite pothuajse nuk ndodhin fare, kjo shpjegohet me karakterin kontinental te klimes me ate rajon.

Numri mesatar i diteve me stuhi

Muaji	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Mes. vjetore
Ditët	1.8	1.9	1.5	2.6	4.1	2.7	2.8	2.1	2.2	2.8	3.4	2.4	30.3

Nga analiza e tabelës rezultojnë se me më shumë ditë në zonën në studim ka 30.3 ditë në vit. Numri më i madh i ditëve me stuhë është në Maj me 4.1 ditë. Shkaku kryesor që maksimumi i ditëve me stuhë vërohet në muajin Maj duhet kërkuar në qarkullimin e masave ajrore dhe në rastin e cikloneve.

Lumi Erzen

Rrjeti hidrografik me ujë mbitokësor është shumë i pasur. Zona është në formën e një lugine të formuar kryesisht nga gërryerjet dhe me pas depozitimet e lumenjve. Rreshjet janë ushqimi i rrjedhjes sipërfaqësore të pellgjeve ujembledhës, si dhe burim për akumulimin e ujerave nëntokësore. Përveç lumit Erzen, në territorin e bashkisë ndodhen liqene dhe perrenj, të cilët e pasurojnë me shumë rrjetin hidrografik.

Lumi Erzen është lumi më i gjatë në rajonin lumor “Ishëm – Erzen”, me një gjatësi prej rreth 109 km në total. Kalon në pjesën lindore e jug-lindore të Bashkisë. Buron në jug-lindje të rajonit, nga Mali me Gropa, prapa vargmalit të Dajtit, duke prerë zonat malore e kodrinore të Shengjergjit e Qaf-Molles dhe duke formuar lugina të thella, sidomos në pjesët e sipërme të rrjedhjes së tij.

Prurja mesatare shumëvjeçare në Sallmonaj arrin në 18 m/sek. Prurja e inerteve 101 kg/sek. Lumi i Erzenit gjatë rrjedhës së tij merr me vete një sërë perrenjsh që derdhen në shtratin e tij duke filluar nga zona e Shengjergjit e Qaf Molles, e duke vazhduar në veri të Krrabes, në zonën e Mulletit, Farkes, Fortuzajt, Arbanes, duke vazhduar drejt Pezes së Vogel, Ndroqit e Shijakut, përshkon neper Ultesirën e Erzenit në veri të qytetit të Durrësit dhe derdhet në detin Adriatik në gjirin e Lalzit.

Pamje nga shtrati i Lumit Erzen



Gjatë rrugës së tij të gjatë, lumi Erzeni ndërpret depozitime nga më të ndryshmet, si shkëmbinj efuzive të zonës së Shengjergjit, shkëmbinj karbonatike të vargmalit të Dajtit

dhe shkembijnj ranore e argjilore ne vazhdim te rrjedhjes se tij. Ne keto pjese, shtrati i lumit eshte me i gjeredhe ka me shume materiale inerte se ne pjeset e tjera. Uji i lumit Erzen ka rrjedhje te shpejte e prurje te madhe dhe ne kohen e reshjeve shtohen shume prurjet e ujit, sa qe shpesh ky lume behet i rrezikshem per zonat e banuara dhe tokat bujqesore, duke shkaktuar permbytje dhe erozion te tokave bujqesore. Ne te dy anet e lumit jane formuar terraca te vjetra lumore. Ne zonen e Pellumbasit dhe grykes se Skoranes, ku lumi Erzen nderpret shkembijnjte karbonatike te Kretakut dhe Paleogjenit, formon nje lugine te thelle e te ngushte me kanione shume te bukur, nje lugine piktoreske dhe me vlera turistike, vlera te cilat shtohen dhe nga prania ne kete zone e shpelles shume te bukur karstike te Pellumbasit, me gjatesi rreth 300 m, gjeresi 4 - 6 - 10m, lartesi 2 - 3 - 4 m., vende - vende 6 - 8 - 10m. Bukuria e kesaj zone shtohet dhe nga diga e ujembledhesit te Skoranes dhe burimi karstik I Pellumbasit qe ndodhet ne lugine, ne veri te fshatit Pellumbas. Te gjitha keto, formojne nje kompleks me vlera gjeoturistike ne afersi te Tiranes.

Karakteristikat gjeologo-inxhinierike te zones

Qellimi i kryerjes se vëzhgimeve:

Njohja e plote e karakteristikave gjeologo-inxhinierike te zones se Bashkise, si dhe te jape disa konkluzione dhe rekomandime per strategjinë. Vlen te permendet, se studimi i perpiluar eshte nje baze per projektuesit dhe do t'u sherbeje atyre per nje zgjidhje sa me te drejte te ndertimit te konstruksioneve inxhinierike.

Kushtet gjeomorfologjike te rajonit

Rajoni ne studim nga pikepamja gjeomorfologjike mund te ndahet ne 2 njesi;

- Njesia morfologjike kodrinore
- Njesia morfologjike fushore

Njesia morfologjike kodrinore

Kjo njesi perfaqeson pjesen kodrinore te rajonit dhe ze pjesen me te madhe te tij. Kjo njesi shtrihet ne lindje te fushes se Durresit (Ndreq) kodrat shtrihen ne trajte vargore veri-jug. Ato kane lartesi mbi nivelin e detit 145-200 m deri 350-400 m.

Pjerrësia shpatore e kodrave eshte e tille:

Ne pjesen fundore te shpatit te kodrave aty ku mbaron njesia fushore dhe fillon njesia kodrinore ne pergjithesi shpatet kane pjerrësi 5-10°. Dhe ne drejtim te rritjes se lartesisë mbi nivelin e detit, kendi i pjerrësisë se ketyre shpateve rritet, duke shkuar nga 5-10 ° (pjesa fundore) deri 10-15° dhe ne zona te vecanta kjo pjerrësi rritet me shume se 15°.

Njesia kodrinore e kesaj zone kryesisht ndertohet nga shkembijnjte e bute dhe me pak nga ato te shkembijnjve mesatarisht te forte dhe te ndermjetem, te cilet perfaqesohen nga shkembijnj argjilore-alevrolitore, ranore dhe alternimet midis tyre.

Njesia morfologjike fushore

Kjo njesi perfshin pjesen me te ulet te rajonit me pjerrësi 0-5°, qe vende vende formon disa ngritje – ulje, qe shtrihen pergjithesisht nga lindja ne drejtim te perendimit dhe veriperendimit, paralel me vargjet kodrinore te trajtuar me siper. Ne kete njesi perfshihet fusha (tarraca) e formuar gjate lugines se lumit Erzen

Ndertimi gjeologjik

Ne depozitimet e zones se marre per studim vecohen fliset e Oligocenit e Akuitanianit dhe shliret e Burdigalianit dhe Tortonianit. Me poshte po trajtojme ne menyre te hollesishme:

Oligoceni i siperm (Pg33)-fliset e Oligocenit te siperm vijojne mbi ato te Oligocenit te mesem dhe perhapen gjeresisht ne juglindje te territorit te bashkise. Oligoceni i siperm ndahet ne tre pako qe nga poshte lart jane:

Flishi i holle argjilo - ranor (Pg33(a)) - perfaqesohet nga flishi ritem holle argjilo - ranor.

Argjilat jane alevrolitore, me ngjyre gri, kompakte. Ranoret jane kokervejel, me ngjyre gri, kompakte. Ne pjesen e sipërme shtohet shume komponenti argjilor.

Flishi ritemholle argjilo-ranor me horizonte vithisese dhe olistolite gelqeroresh, mergelesh e konglomeratesh (Pg33(b)).

Flishi i holle argjilor me ndershtresa te rralla ranoresh (Pg33(c))-argjilat jane gri ne te kalter, kompakte, karbonatike, me ndertim masiv. Ranoret jane kokerimet deri kokerr vegjel, ngjyre gri. Rralle takohen horizonte vithisese.

Akuitiani (NI Ia)-pergjithesisht jepet i ndare ne dy pako qe jo gjithkund vecohen ne terren.

- *Pakoja e poshtme argjilito - konglomeratike (NI Ia(a))-perfaqesohet nga nderthurje argjilash e konglomeratesh.*

- *Pakoja e sipërme flish i holle argjilor (NI Ia (b))-ka dhe ndonje shtrese te holle ranorike. Argjilat jane masive, me ngjyre gri te kalter.*

Burdigaliani (NI Ib)-depozitimet e Burdigalianit takohen ne pjesen jugore te zones se studiuar. Ato ndahen ne 4 pako litologjike. Pergjithesisht verehen perfaqesime litologjike me dominim here te njerit, here te tjetrit komponent litologjik. Ne ndarjen me 4 pako nga poshte lart vecohen:

- *Argjila, ranore, mergele (NI Ib (a))-perfaqesohen nga nderthurje flishore ritem holle argjiloro - ranore, me mergele te rralla. Argjilat jane ngjyre gri, kompakte. Ranoret jane shtrese holle, kokerr vegjel, ngjyre gri-bezhe.*

- *Mergele, argjila, gelqerore (NI Ib (b))*

- *Ranore, mergele, argjila mergelore, gelqerore (NI Ib(c))-perfaqesohet nga nderthurje ranoresh, argjilash mergelore, mergelesh dhe gelqeroresh foraminiferike. Mergelet jane shtresore deri masive, me ngjyre gri, kompakte. Argjilat jane ngjyre gri, pak kompakte. Gelqeroret paraqiten ranorike, gri - bezhe.*

- *Mergele, mergele argjilore, ranore, gelqerore litotamnike dhe horizonte vithisese (NI Ib(d)) - kjo pako eshte pak a shume e ngjashme me ate te meposhtmen, por karakterizohet nga shfaqja e gelqeroreve litotamnike dhe prania e horizonteve vithisese. Ne ndarjen ne dy pako vecohen:*

- *Argjila, argjila mergelore me konkrecione mergelesh, ranore (NI Ib (a)) - argjilat jane masive, ngjyre gri te kalter, pak kompakte, me konkrecione mergelesh te permasave nga disa centimetra deri ne 1 m diameter. Ne pjesen e sipërme perfaqesohet nga nderthurje argjilo - ranore dhe ndonje konglomerati ne trajte linzash. Ranoret jane kokerr mesem, ngjyre gri bezhe, kompakte, me natyre vithisese.*

- *Mergele, argjila mergelore, horizonte vithisese (NI Ib (b)) - mergelet jane masive me*

ngyre gri -bezhe, kompakte. Horizontet vithisese e konglomeratet rrallë mbyllen në shtrirje, duke kaluar në argjila mergelore. Në sektorin e Cacabezes, etj. Evidentohen ndryshime të theksuara litologjike.

Tortoniani N_{13t} - formacionet e Tortonianit ndertojnë pothuajse të gjithë sinklinalin e Tiranës. Në sinklinalin e Tiranës vecohen 4 formacione të Tortonianit:

Formacioni Priska (N_{13t(a)}) - fillon me një horizont konglomeratesh ose brekcesh bazale.

Pjesa e poshtme e prerjes përfaqësohet nga ranore shtrese trashë, masive, me ndershtresa alevrolitesh ose ranorësh gravelitike të kuqërremte. Në pjesën e mesme të prerjes shihen ndershtresat alevrolite mes ranoreve, ndërsa në pjesën e sipërme shfaqen gelqeroret rife, kryesisht litotamnike, të cilat drejt veriut pykëzohen. Në sektorin qendror - jugor, mbi ranoret gravelitike të kuqërremte vijnë ndërthurje argjilo - alevrolitike - ranorike me qymyrë e stome ostreash. Në malin e Dajtit drejt Priskës mbi boksitë kemi konglobrekce, gelqerore, etj.

Formacioni Skuterra (N_{13t(b)}) - përfaqësohet nga ndërthurje paketash të trasha argjiloro - alevrolitike, ngjyrë hiri të kalter, me ndershtresa të rralla ranorësh polimikte kokmze imetmesem deri gravelitike në pjesën e poshtme.

Formacioni Iba (N_{13t(c)}) - ranore shtrese trashë deri masive me shtresezim të gershetuar. Rrallë ndershtresa e thjerza gravelitike. Ngjyra e ranoreve verdhacake e çelët, paksa e kuqërremte.

Hidrogeologjia

Në lidhje me llojet litologjike dhe vetitë hidrogeologjike të tyre në rajonin e studiuar dallohen keto komplekse ujëmbajtëse :

- a) Kompleksi i formimeve të Kuaternarit.
- b) Kompleksi i shkëmbinjeve mollasike.
- c) Kompleksi i shkëmbinjeve shlire.

a-Kompleksi i formimeve të Kuaternarit.

Perhapen kryesisht gjatë luginës së lumit Erzenit, që në pjesën e sipërme të prerjes gjeologo-litologjike ndërtohet nga dhëra suargjilore me trashësi 0.5-1 m deri 2m, me veti shumë të uletës filtruese. Pashtë këtyre depozitimeve zhvillohen depozitimet zhavorrore që kanë veti të mira filtruese. Niveli ujërave nentokesore takohet pashtë 3 m në gjithë hapësirën e fushës. Edhe keto ujra nuk janë agresive ndaj betonit.

b & c - Kompleksi i shkëmbinjeve mollasike, shlire, flishore

Në lidhje me ujëmbajtjen ato janë të varfër. Ujrat e këtyre komplekseve lidhen kryesisht me shkëmbinjtë ranore. Nga keto formacione dalin disa burime të rralla me prurje të vogël deri 1.0 l/sek. Niveli i ujërave nentokesore në keto shkëmbinj takohet pashtë 15 m.

Rreshqitjet

Gjatë punimeve fushore me anë të marshutave gjeologo-inxhinierike janë evidentuar dhe hartografuar shumë rreshqitje si dhe vatra erozioni të cilat po i analizojmë me pashtë.

Pjesa më e madhe e zonës së studiuar përbehet nga një reliev kodrinor shpatet e të cilat kanë një pjerrësi nga 10-15° deri 20-30°. Sikurse e kemi thënë edhe me sipër, këto pjesë e ngritur e relievit, përgjithësisht ndërtohet nga shkëmbinjtë mesatarisht të fortë dhe të butë. Gjithashtu në shpatë të kodrave vendosen dhe depozitime deluviale – koluviale (argjila, suargjila, rera, copa ranorësh) e cila bashkë me koren e prishjes pas rënies së

shirave, si rezultat i ngopjes me uje, ne kushte te vendosjes se tyre ne shpate te pjerret, kemi prishje ekuilibri dhe si rrjedhim dherat zhvendosen poshte ne drejtim te shpatit, duke formuar rreshqitjet, qe jane te tipit rreshqitje-rrjedhje.

Ato ne pergjithesi jane zhvilluar ne lugina dhe peroska te zonave kodrinore. Kane gjeresi 70-100 m deri 250-500 m, gjatesi 100-300m deri 1000 m dhe trupi rreshqites ka trashesi qe varion nga 1-2 m deri 8-15 m Masa levizese perbehet kryesisht nga material argjilor, suargjilor, rere (qe permbajne copa ranoresh), zhavore etj.

Zonimi litologjik i shkembinjve

Si rezultat i te dhenave te fituar nga punimet fushore dhe literatura arshivale ne lidhje me temen ne fjale eshte bere e mundur deshifrimi i perberjes litologjike te zones se studiuar.

Trualli i studiuar sipas gjenezes se formes se shkembinjve ndahet:

- Shkembinjte molasik- Shkembinj argjilo-alevrolitik me nderthurje ranoresh dhe nderthurje shtresash (Ma.al.r),
- Shkembinjte ranore (M.r),
- Shkembinjte ranore-agjilore (Mr.a).
- Shkembinjte Shlire-Shkembinj argjilore-ranore-mergele-gelqerore
- Dhera me kohezion- Suargjila pluhurore me ndershtresa surerash
- Dhera pa kohezion-Zhavore aluviale

Klasifikimi gjeoteknik i shkembinjve

Per klasifikimin gjeoteknik te shkembinjve, si kriteret kryesore jane marre perberja litologjike e shkembinjve dhe vetite fiziko-mekanike te tyre. Ne baze te ketyre treguesve eshte bere bashkimi i grupeve te shkembinjve te anlizuar ne paragrafin e mesiperme ne zona, sipas te cilave rajoni i studiuar u nda ne:

- Zona e shkembinjve te ndermjetem
- Zona e shkembinjve mesatarisht te forte
- Zona e shkembinjve te bute
- Dhera me kohezion dhe pa kohezion

Në përfundim, mund të themi se:

- Zona ndertohet nga shkembinj te bute, mesatarisht te forte dhe te ndermjetem.
- Ne zone jane te zhvilluar fenomenet gjeodinamike.
- Studimi eshte i vlefshem per studimin e pergjithshem te Bashkise Shijak

Kapitulli 2: Analiza e dokumenteve të planifikimit të hartuara më parë

Kater reforma institucionale baze jane aktualisht ne proces, te cilat do te ndikojne ne sektorin rural: Strategjia per Zhvillim Ekonomik dhe Social, Programi i Buxhetit Afatmesem, Procesi i Decentralizimit dhe Reforma ne Administraten Publike. Reformat jane me objektive te percaktuar qarte dhe nese implementohen sic duhet, do te sillnin nje ndikim pozitiv edhe ne zhvillimin e zonës së studiuar. Ato e fuqizojne pushtetin vendor me te gjitha kompetencat per t'u perfshire ne menyre me te drejtperdrejte ne shperndarjen e buxheteve dhe vendimmarrjes, ato mbeshtesin reformat edhe në sektorin e bujqesise dhe atë të ushqimit dhe bejne qe ajo te funksionojë ne menyre me eficiente dhe me kapacitet me te larte, si dhe lejojne nje diskutim me pjesemarrje me te gjere mbi

shperndarjen ne teresi te burimeve shteterore. E ndersa reformat kane filluar kudo, ato vijne e ngadalesohen ne fazen aktuale te implementimit, pasi shpesh iu mungojne plane veprimi te detajuara dhe tregues monitorimi. Nje pune voluminoze e pret Shqiperine per te vene ne zbatim keto reforma shume te admirueshme dhe do te duhet ende shume kohe deri sa perfitimet e tyre te ndihen nga popullsia në nivel bashkie.

Ndersa nje strategji ambicioze decentralizimi po zbatohet qe nga viti 2000, sfida e qeverise do te jete sinkronizimi i strukturave institucionale me strukturat e reja lokale dhe percaktimi i qarte i kompetencave te pushtetit qendror dhe atij lokal. Strategjia e decentralizimit synon transferimin e nje numri te konsiderueshem pergjegjesish nga qeveria qendrore drejt pushtetit vendor, duke i dhene mundesine komunitetit per nje angazhim me te fuqishem ne akordimin dhe shfrytezimin e fondeve. E rendesishme eshte qe te forcohen kapacitetet ne nivelin lokal, garantohet aktivizim me energjik dhe identifikohen sherbimet per te cilat decentralizimi nuk do te ishte i pershtatshem.

Permiresimi i administrates publike do te jete nje fushe tjeter kyce e reformes me rekomandime edhe per çdo bashki, përfshirë edhe bashkinë Shijak. Kalimi i punonjesve te kesaj bashkie ne nepunes civile do te jete i rendesishem per te siguruar me shume qendrueshmeri dhe siguri te stafit dhe per te terhequr staf te nje cilesie te larte. Pergjate vitit 2016 do te rishikohen pergjegjesite dhe kompetencat per brenda strukturës së bashkisë si dhe do te behet nje vleresim i kapaciteteve. Shpresohet qe sistemi te behet me eficient dhe me pak i influencuar politikisht. Ndersa pagat mund te mos jene aq konkurrese sa per te terhequr personel te kualifikuar ne sherbimin civil.

Nga ana tjeter, rruga drejt integritetit Europian, do te ndikojte ne reformat ne fushen e politikave dhe ato institucionale. Avantazhe dhe disavantazhe shoqerojne kete integrim si dhe angazhimin e bashkisë në projekte rajonale, ndërkufitare të financuara nga Bashkimi Evropian. Afrimi me BE ofron avantazhe ne drejtim te hapesirave tregtare, mundesive per punesim dhe investitoreve potenciale. Afersia me Italine dhe Greqine dhe qasja direkte në portin e Durrësit, sigurojne rruge tregtie, prej te cilave mund te perfitoje ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në territorin e bashkisë. Instrumenti i ndihmës së para-antarësimit i BE ofron mundesi per bashkinë qe te hyje ne marreveshje ndërkufitare rajonale zhvillimi dhe te perfitoje mbeshtetje shtese. **Megjithate, do te ishte shume e domosdoshme qe bashkia te ndertoje nje program pune per financimin e projekteve të saj të zhvillimit në kuadër të programeve mbështetëse të BE, ne menyre qe investimet te drejtohen aty ku ato nevojiten me shume.** Disavantazhet e ketij afrimi, reflektohen ne numrin e produkteve qe importohen ne Shqiperi nga tregu i BE, te cilat dobësojnë sipërmarrjet dhe produktet lokale si dhe ne paaftesine e prodhimit vendas per te konkuruar me keto importe. Nje perafim i shpejte me standartet e BE, mbart rrezikun qe financimi te orientohet drejt arritjes se standarteve te cilesise se larte, te cilat as nuk mund te jene nje prioritet per Shqiperine ne keto momente, dhe per me te teper nuk ekzistojne as kapacitetet per t'i arritur keto standarte, dhe per pasoje ekziston edhe rreziku potencial per te nxitur korrupsionin. Ekziston nje boshllek i madh ndermjet mjeteve ekzistuese te prodhimit dhe standarteve te cilesise te drejtuar nga BE, i cili nevojitet te mbushet perpara investimit ne ndermarrje perpunuese qe permbushin standartet e BE.

Të dhëna të përgjithshme

Cilesia e mjedisit vizual të një zone, varet nga kushtet e pejsazheve rrethuese, ndersa cilesia e mjedisit të jeteses, e cila është kryesisht e lidhur me kushtet e shëndetit publik, varet kryesisht nga cilesia e ajrit, ujit, dheut dhe mbuleses vegetative të zones. Nga kjo pikepamje, cilesia e mjedisit të Bashkise, ka qene subjekt i ndotjeve të ajrit, ujit dhe tokes. Me poshte jane dhene detaje per secilin nga keta elemente.

Te dhenat fiziko-geografike dhe klimaterike

Zona e studiuar paraqitet një terren kodrinor-fushor me një lartësi mesatare rreth 200 m mbi nivelin e detit dhe me toka pjellore. Ka një pozite gjeografike mjaft të favorshme në komunikimin e afert dhe të largët me qendrat e tjera urbane të vendit, fale pozicionit në lidhje me rrjetin rrugor nacional dhe rajonal ndër me kryesoret në vend. Bashkia ndodhet vetëm 10 km larg qendres së Durrësit dhe 35 km larg asaj të Tiranës. Gjithë territori i komunes përshkohet nga lumi i Erzenit në një gjatësi prej 10 km.

Pasurite ujore të këtij rajoni janë të kenaqshme dhe kanë një rendësi të vecante në garantimin e jetes sociale dhe ekonomike. Rrjeti hidrografik është shumë i pasur. Reshjet janë ushqimi ujor i rrjedhjes sipërfaqësore të pellgjeve ujembledhës si dhe akumulimit të ujërave nëntokësore. Bota bimë dhe shtazore e rajonit është transformuar shumë nga veprimtaria e njeriut.

Bimesia që dominon në zone, përveç bimëve të arave, janë edhe pemët frutore, si dhe ullinjtë, meqenëse në këto zone ka shumë kodra që janë të pershtatshme për rritjen e kësaj kulture. Ullishtat përbejnë një përqindje të madhe të drurëve të cilët mbulojnë zonat kodrinore. Në potencialet natyrore, një rol të rëndësishëm ka luajtur lumi i Erzenit me inertët e pashtershëm të tij. Të gjitha këto përbejnë një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e gjithanshëm ekonomik të rajonit.

Lumi Erzen përfaqësohet nga tre stacione në rrjetin e monitorimit të cilësive së ujërave sipërfaqësore. Këto stacione janë: Ibe (stacion në rrjedhën e sipërme të lumit), Ndroq (stacion në rrjedhën e mesme të lumit) dhe Sallmonë (stacion në rrjedhën e poshtme të tij). Me këto tre stacione në mund të gjykojmë mbi gjendjen e cilësive së ujërave të këtij lumi. Në stacionin e Ibes, të zgjedhur si stacion referencë, ujrat janë të pasura me oksigjen dhe të cilësive shumë të mira, ndersa për stacionet e Ndroqit dhe të Sallmonës, këto ujëra janë të cilësive së mire, me vlera brenda intervalit 6.4 – 9 mg/l O₂, (Tabela 1). Vlera e këtij treguesi në stacionin e Sallmonës është në nivelin e 7.8 mg/l O₂ dhe 9.8 mg/l O₂, kjo tregon një ndikim më të madh të ndotjes nga shkarkimet urbane në këto stacion, pasi vlerat e këtij parametri tregojnë shtimin në ujë të kompozimeve ndotëse që kërkojnë sasi më të madhe oksigjeni. Krahasimi i vlerave mesatare me vlerat limite (sipas NIVA) tregon se këto ujëra janë të cilësive së mire, brenda intervalit 6.4 – 9 mg/l O₂.

Pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave urbane

Sherbimi i pastrimit në Bashkinë Shijak para vitit 96 ka qene shtetërore ish ndermarrja “Komunake”. Pas viti 96 pra, ky sherbim kaloi në sipërmarrje private dhe vazhdon edhe sot e kësaj dite. Sipërfaqja e sherbimit të pastrimit përfshin rruget dhe trotualet dhe mbulon rreth 47370 m²

Te dhenat per tarifen e pastrimit qe paguan popullsia dhe bizneset private jane:

1. Per familjaret ----- 1000 leke/ familje ne vit
2. Per automjetet ----- 6.000 deri ne 10.000 leke/ vit
3. Per biznesin e vogel ----- 8.000 deri ne 18.000 leke/ vit
4. Per biznesin e madh ----- 25.000 deri ne 70.000 leke vit

Mbetjet urbane dhe ato ndertime ne Bashkine Shijak llogariten rreth 6244 ton ne vit.

Mbetjet urbane llogariten 3744 ton/vit kurse ato ndertimore 1500 ton/ vit.

Sherbimi I pastrimit eshte me sipermarrje private, tenderi I te cilit u zhvillua ne vitin 2010 deri ne 2015. Sherbimet qe kryen firma private eshte :

1. Fshirje me fshese rruge+sheshe ----- 1.960.969 leke
2. Grumbullim dhe transporti I mbeturinave per ne landfill ----- 4.659.847 leke
3. Mirembajtje druresh dekorativ ----- 186.875 leke
4. Mirembajtje sipërfaqe bari dekorativ ----- 44.623 leke
5. Mirembajtje lule sezonale ----- 172.485 leke
6. Mirembajtje gardhi gjeler ----- 13.445 leke
7. Mirembajtje rruge dhe sheshe ne sipërfaqe te gjelber ----- 111.829 leke
8. Mirembajtje varrezash ----- 764.638 leke

Cilesia e peisazhit dhe mjedisi natyror

Megjithese ne Shqiperi ekzistojne ligjet kombetare per mbrojtjen e pejsazheve (disa prej tyre jane te lidhura me trashegimine kulturore dhe historike te Shqiperise), aplikimi I ketyre ligjeve ne nivel lokal eshte nganjehere i pamjaftueshem. Ne strukturen insitucionale te baskise nuk ka nje department te vecante qe te kete pergjegjesine statutore per te mbrojtur mjedisin nga degradimi i pejsazheve natyrore te territorit.

Burimet natyrore

Lumi Erzen eshte elementi me i forte natyror qe i jep jete gjithe bashkise. Eshte realisht arsyeya kryesore per formimin e lugines dhe banimin e zones. Eshte nje lume i vogel, por shume i rendesishem per Bashkine. Gjithashtu, ne terrotrpine e bashkise jane te pranishme edhe 2 burime kryesore. Burimi I Gjyshit dhe burimi I Dushkut.

Ligjet kryesore mjedisore

Politika mjedisore identifikon objektivat prioritare te meposhteme:

1. Perforcimi i kapaciteteve manaxhuese mjedisore ne nivel lokal dhe kombetar nepermjet elementeve te meposhtem:

- duke zhvilluar kuadrin e nevojshem ligjor;
- duke siguruar integrimin e konsideracioneve mjedisore ne politikat dhe programet e zones;
- duke permiresuar gjendjen mjedisore ne pikat e nxehta te identifikuara;
- duke promovuar ndergjegjesimin mjedisor.

2. Implementimi i parimeve te zhvillimit te qendrueshem dhe integruese ne favor te burimeve natyrore.

Duke qene se kuadri ligjor ka nje impakt direkt, evident ne kete studim dhe neinstrumentat institucionale relevante eshte paraqitur me poshte:

Ligji nr 8906, dt 6.06.2002 “Mbi zonat e mbrojtura” perkufizon rregulloret per deklarimin, ruajtjen, administrimin dhe perdorimin e pershtatshem te zonave te mbrojtura dhe

burimeve te tyre natyrore biologjike. Ky ligj ndalon ose kufizon prerjen e drureve, shkurreve, perdorimin e substancave kimike, gjuetie, levizjen e kafsheve shtepiake, ndertimet e cdo lloji etj. Ligjil ben institucionet qendrore dhe pushtetin lokal pergjegjes per formulimin e planeve te menaxhimit te zonave te mbrojtura. Nje plan menaxhimi vendos objektivat e menaxhimit per zonat e mbrojtura, mekanizmat perkatese dhe autoritetet e pershtatshme si dhe aktivitetet e lejuara dhe te palejuara. Cdo ndryshim ne statusin e zonave te mbrojtura sanksionohet nga Keshilli i Ministrave me propozimet e Ministrise se Mjedisit.

Ligji “Mbi biodiversitetin”, 2006. Ne vitin 1999 u hartua “Strategjia e biodiversitetit dhe Plani i Veprimit” (BSAP). Nje nga synimet e BSAP ishte zgjerimi dhe perforecimi i rrejtit te zonave te mbrojtura. Plani i rinovuar Kombetar i Mjedisit (NEAP) i vitit 2002 (ai original ishte i vitit 1992-1993) dhe Strategjia Kombetare e Mjedisit (NES) e vitit 2006 kane perpunuar politikat mjedisore te vendit. Keto dokumenta te rinovuara, pervijojne masat qe duhet te ndermerren per mbrojtjen e mjedisit dhe aktet e normativat qe duhet te aprovohen. Ne vitin 2003, u ngrit nje komitet intersektorial per implementimin e NEAP.

Ligji nr 8934, dt 05/09/2002 “Mbi mbrojtjen e mjedisit” Qellimi i ketij ligji eshte mbrojtja e komponenteve dhe proceseve te mjedisit si dhe perdorimin racional te mjedisit dhe kufizimin e shkarkimeve dhe ndotjen ne te. Nje objektiv tjetër i ketij ligji eshte reabilitimi i mjedisit te demtuar, permiresimi i kushteve mjedisore qe lidhen me cilesine e jeteses, dhe mbrojtjen e shendetit te njeriut si dhe koordinimin e aktivitetit publik me qellim qe te permbushen kerkesat per mbrojtjen e mjedisit.

Ligji nr 8990, dt 23/11/2003 “Mbi vleresimin e impaktit ne mjedis” Qellimi i ketij ligji eshte te siguroje nje vleresim te pergjithshem dhe te sinkronizuar te impakteve ne mjedis, nga projektet ose aktivitetet qe do te implementohen, duke parandaluar dhe reduktuar efektet e demshme si dhe kryejne nje proces vleresimi te hapur dhe te paanshme nga autoritetet lokale, publiku dhe OJQ mjedisore.

Kapitulli 4: Analiza e problematikës mjedisore

Ajri

Duke qenë se të dhënat mbi cilësinë e ajrit vetëm për Bashkinë Shijak mungojnë, të dhënat janë marrë për qytetin më të afërt, atë të Durrësit. Pritet që vlerat e treguesve kryesore të ndotjes (PM₁₀, PM_{2.5}, NO₂, SO₂, O₃, CO dhe BTEX) për Shijakun të jenë më të ulta në krahasim me Durrësin.

Sipas raportit të gjendjes në mjedis për qytetin e Durrësit mund të vleresohet se cilësia e ajrit është e mirë. Ndotësit kryesorë të ajrit janë PM₁₀, PM_{2.5}, SO₂, NO₂, O₃ edhe pse rezultojnë të jenë brenda normave të lejuara.

Sipas raportit të AKM për stacionin e ngritur në Durrës vlerat mesatare vjetore të grimcave PM₁₀ dhe PM_{2.5} nuk tejkalojnë vlerën kufi të standarteve të BE. Për Shijakun këto vlera pritet të jenë më të ulëta pasi numri i makinave që qarkullojnë, pluhuri dhe ndërtimet janë në numër më të vogël në krahasim me Durrësin. Sipas monitorimit të kryer për periudhen 2012-2014 ka një trend në ulje të këtij parametri.

Grimcat e PM₁₀ dhe PM₁₀ janë të rrezikshme për shëndetin e popullatës pasi depërtojnë thellë në mushkëri duke shkaktuar probleme serioze të cilat çojnë edhe në vdekje të parakohshme. Ato mund të shkaktojnë dhe përkeqësojnë sëmundjet e zemrës. Dëmtojnë sistemin nervor qendror, sistemin prodhues dhe mund të shkaktojnë kancer.

Një tjetër tregues i cilësisë së ajrit është edhe sasia e NO₂ (dioksid azoti). Vlerat vjetore të tij për qytetin e Durrësit nuk i tejkalojnë standartet e BE. Për NO₂ burimi kryesor i ndotjes është shkarkimi i automjeteve. Vlerat e këtij ndotësi pritet të jenë më të ulta për Shijakun pasi numri i automjeteve që qarkullojnë është më i ulët në krahasim me dy qytetet më të afërta të Durrësit apo Tiranës. Ka një trend në rritje të këtij parametri vitet e fundit edhe pse është brenda normës së lejuar.

NO₂ është i lidhur me efekte të padëshiruara në shëndet, ku mund të dëmtojë mëlçinë, mushkëritë, shpretkën dhe gjakun. NO₂ ndikon në formimin e shiut acid dhe në eutrofikimin e tokës dhe ujit.

Gjithashtu niveli i SO₂ (dioksid squfuri) është më i ulët në krahasim me standartin orar dhe ditor të BE-së. Edhe pse vlerat e tij janë brenda normave të lejuara, ka një trend në rritje të këtij parametri vitet e fundit.

SO₂ është një ndotës që shkakton problem serioze në shëndetin e popullatës si përkeqësimin e astmës si dhe redukton funksionin e mushkrive dhe irriton aparatit respirator. Kjo mund të shkaktojë dhimbje koke, shqetësim dhe ankth. SO₂ ndihmon në formimin e shiut acid, impakti i të cilit mund të jetë i dukshëm duke shkaktuar dëmtimin e pyjeve dhe ekosistemin e lumenjeve dhe liqeneve.

Vlerat e O₃ (ozonit) për Durrësin janë në vlera normale. Ka një trend në ulje të nivelit të O₃ për periudhën 2011-2014. Nivele pak më të larta vërehen gjatë muajve të nxehtë të verës.

Niveli i lartë i ozonit mund të shkaktojë problem të shëndetit respirator duke zvogëluar funksionimin e mushkrive, përkeqësimin e astmës dhe sëmundjeve të tjera të mushkrive deri në vdekje të parakohshme. Ozoni gjithashtu është gaz me efekt serë duke kontribuar në ngrohjen e atmosferës.

Vlerat e CO (monoksidi i karbonit) për Durrësit janë brenda normave të lejuara dhe e njëjta gjë pritet të jetë edhe për Shijakun. Burimet kryesore të shkarkimit të CO në ajër janë transporti rrugor, biznesi, shtëpitem dhe industria.

CO është një ndotës që në nivele të larta mund të shkaktojë probleme në zemër dhe të dëmtojë sistemin nervor. Gjithashtu mund të shkaktojë dhimbje koke, marramendje dhe lodhje.

Ujrat

Të dhënat mbi cilësinë e ujrave janë marre nga monitorimet e kryera nga AKM si dhe vëzhgimet në terren. Lumi Erzen është monitoruar në fshatin Sallmone të Bashkisë Shijak. Rezultatet tregojnë se cilësia e ujrave në lumin Erzen (stacioni Sallmone) është kategoria e III-të ose gjendje e moderuar. Ndotja vjen si pasojë e ndikimit të shkarkimeve urbane dhe industriale.

Ujrat e lumit Erzen rezultojnë të pasura me oksigjen dhe klasifikohen të cilësisë së parë. Megjithatë, përcjellshmeria elektrike është në vlera të larta gjë që tregon që ujrat e Erzenit janë nën ndikim të vazhdueshëm të shkarkimeve të lëngëta urbane dhe industriale.

Ndërsa përmbajtja e lëndës organike e cila shprehet nëpërmjet NBO_5 , vlerësohet në gjendje të moderuar. Ujrat e lumit Erzen janë vlerësuar të ndotura dhe të cilësisë së tretë për këtë tregues. Shkaqet për këtë janë shkarkimet urbane dhe industriale të patrajuara. Për periudhën 2010-2014 vërehet tendenca në rritje e këtij parametri.

Përmbajtja e NKO si tregues i ndotjes organike dhe kimike në ujrat e lumit Erzen rezulton në rritje. Kjo vjen sërish si pasojë e shkarkime urbane në lum.

Për sa i përket përmbajtjes mesatare të fosforit dhe nitriteve, ujrat e Erzenit janë vlerësuar të një cilësie të mirë. Kjo përmbajtje paraqitet e qëndrueshme për periudhën 2010-2014.

Ujrat e Erzenit klasifikohen të cilësisë së dytë për përmbajtjen amoniakut. Kjo pasi ujrat e lumit kalojnë afër zonave të banuara dhe janë nën presionin e shkarkimeve urbane të patrajuara. Për të njëjtën arsye ka një rritje të ndjeshme në krahasim me vitin 2013 të përmbajtjes së amoniakut në ujrat e lumit.

Në lidhje me cilësinë e ujërave nëntokësore, të dhënat janë marrë nga monitorimi i bërë nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) në bazenin e lumit Erzen për periudhën 2010-2014 të krahasuara me standartet shqiptare dhe europiane. Monitorimi dhe vlerësimi i tyre është tepër i rëndësishëm pasi këto ujra janë minerali më jetik për popullatën. Pavarësisht se janë vlerësuar me veti të mira fiziko-kimike urrat nëntokësore të tij janë në presion dhe shfrytëzim të vazhdueshëm nga banorët duke çuar në ndotje të tyre. Kjo vjen edhe për arsyen se infrastruktura dhe rrjeti i kanalizimeve janë tepër të vjetëruara.

Monitorimi i burimeve ujore që përdoren për ujtim është bërë nga (SHGJSH) në Xhafzotaj. Monitorimi është bërë në rezervuarin e Xhafzotajt në veprën e marrjes së ujit të kanalit kryesor ujitës të ujëlëshuesit ku ndodhet dhe vepra e marrjes së ujit të kanalit kryesor ujitës. Vihet re se uji është brenda normave të lejuara me një tendencë të lehtë të biokarbonatëve në kufijtë HCO_3 ç 16.900 të mesatarizuara.

Cilësia e ujit të rezervuarit është e mirë dhe mund të përdoret për ujtimin e bimëve që kultivohen në zonë.

Zhurmat

Sipas monitorimeve në terren niveli i zhurmave është në nivelin mesatar dhe brenda normave të lejuara. Megjithatë niveli i zhurmave është më i lartë në qytetin e Shijakut dhe përgjatë autostradës dhe më i ulët në zonat rurale. Rekomandohet shtimi i sipërfaqeve të gjelbërta midis zonave të banuara dhe rrugëve kryesore për të reduktuar nivelin e zhurmave si dhe programe ndërgjegjësuëse për qytetaret ndaj ndikimit negativ të zhurmave.

Mbetjet

Shijaku ka një sipërfaqe prej 92.12 km^2 dhe një popullsi sipas regjistrimit civil prej 44 103 banorësh. Popullsia ka ardhur duke u rritur pas viteve 90' si rezultat i migrimit të popullatës kryesisht nga zonat verilindore të vendit. Kjo rritje e popullsisë ka rënduar

situatën e menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane dhe gjetjen e vendepozitimeve për trajtimin dhe asgjësimin e tyre.

Vendepozitimi i mbeturinave urbane në Shijak ndodhet vetëm 1 km larg qendrës së qytetit, ndërsa sipas vëzhgimeve rezulton se në këtë vend ndodhen qindra tonë mbetje urbane të papërpunuara.

Gjithashtu nuk ka një system për administrimin e mbetjeve të rrezikshme (atyre të prodhuara nga industritë dhe ato shtëpiake) të cilat janë një rrezik potencial për shëndetin e njeriut.

Grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve në qytet bëhet nga bashkia ndërsa zonat rurale nuk janë të mbuluar me këtë shërbim. Kjo për shkak të mungesës së kapaciteteve njerëzore dhe mjeteve për shërbimin e pastrimit në Bashki dhe Njësitë Administrative. Po ashtu, buxheti tepër i limituar dhe mungesa e koordinimit mes Bashkisë dhe Njërive Administrative për shërbimin e pastrimit kanë çuar në një nivel të dobët menaxhimi të mbetjeve urbane.

Një pjesë e madhe e mbetjeve depozitohen në lumin Erzen nga vetë banorët dhe bizneset duke qënë shaktarët kryesorë të ndotjes së tij. Përgjatë rrugëve nuk gjenden kosha metalik ku banorët e zonës të depozitojnë plehrat e tyre ose kur egzistojnë koshat, ato janë të tejmbushur.

Riciklimi i mbetjeve është në fazën fillestare. Trajtimi bëhet nëpërmjet groposjes. Pjesa më e madhe e mbetjeve të riciklueshme vjen nga mbetjet urbane dhe nga industria. Nuk ka impianti të kompostimit të mbetjeve të biodegradueshme dhe të djegies së mbetjeve urbane (të pa riciklueshme) si dhe mbetjeve industriale.

Depozitimi i mbetjeve në fushat e improvizuar përbën një rrezik të mundshëm për shëndetin e njeriut, burimet natyrore (tokën, ujë, ajër) si dhe për zhvillimin e turizmit.



Toka

Ndërhyrjet e shumta në lumin Erzen kanë çuar në ngushtimin e shtratit të tij për shkak të erozioni fundor dhe shfrytëzimit të inerteve në disa pika të tij. Disa shtëpi banimi janë ndërtuar mbi kolektor duke e vështirësuar gjendjen. Ndërhyrjet kanë bërë që në qytetin e Shijakut dhe në disa fshatra ku kalon lumi të ketë përmbytje 2-3 herë në vit. Ky

është kthyer në një fenomen shqetësues kryesisht për banorët e lagjes Erzen në qytetin e Shijakut dhe fshatit Gjepalaj.

Prandaj rekomandohet të mbillen bimë endemike dhe pemë përgjatë shtratin të lumit me qëllim uljen e erozionit. Kjo do të përmirësonte edhe pamjen vizive të lumit dhe mund të krijohet një shetitore e këndshme për banorët buzë lumit. Gjithashtu rekomandohet eliminimi i ndërhyrjeve në shtratin e lumit si dhe ndërmarrja e një sërë masash me karakter inxhinierik e hidroteknik me qëllim menaxhimin dhe mirëmbajtjen e bazenit të lumit.

Fenomene të rrëshqitjes dhe erozionit vihen re edhe në tokat bujqësore. Keto faktorë ndikojnë negativisht në humbjen apo deformimin e tokës.

Biodiversiteti

Bimësia mbizotëruese janë shkurret mesdhetare të njohuar si formacionet e makjes, shqopës, maresë, dëllinjës, frashërit, dushkut. Gjithashtu në zonë vihet re edhe prania e shelgut, plepit dhe ullirit. Këto formacione bimore përbejnë potencial për zhvillimin e ekoturizmit dhe agro-pylltarisë.

Për sa i përket faunës ajo është tipike e zonave rurale të ultësirën perëndimore të Shqipërisë. Disa nga specie kryesore që mund rriten në këtë zonë janë dhelpa, lepuri i egër, nuselala, kunadhja, ketri, iriqi, urithi. Gjithashtu ka edhe specie të herpetofaunës të tilla si breshka e tokës, haudhuca, bullari, gjarpri i ujit, bretkoca etj.

Shpendët që hasen më zakonisht janë ato të rendit të harabelorëve si harabeli i shtëpisë, mëllenjat, bishttundësit, kumria, qyqja, gardalinat, sorrat, laraskat etj. Llojet grabitqare janë përgjithësisht të rrallë, ndër të cilët haset huta e zakonshme dhe kukuvajka.

Në disa rezervuare të Shijakut vihet re prania e llojeve të peshqve të introduktuar si ballgjeri dhe karasi. Ndërsa në përroin e Gërdecit haset gjuca.

Pyjet dhe kullotat

Sipas reformës më të fundit territorial – administrative, Bashkia Shijak do të ketë në administrim të saj rreth 491.5 ha pyje dhe kullota. Përkatësisht të transferuara me VKM nr.109, dt.03/02/2008 pranë Njesisë Administrative Maminas (439 ha pyje dhe kullota) dhe me VKM nr.173, dt.13/03/2008 pranë Njesisë Administrative Gjepalaj (52.5 ha pyje e kullota).

Kapitulli 5 Zhvillimi Rajonal

Pikat e forta dhe mundësitë	Pikat e dobëta dhe kercenimet
1. Pozicioni gjeografik 2. Kushtet klimatiko - tokësore 3. Tradita në kultivimin e vreshtave, ullinjve, perimeve 4. Afërsia me tregjet e Tiranës dhe Durrësit 5. Sasia e tokës së pa punuar, në dispozicion (oportunitet) 6. Mundësia për krijimin e grupeve sipas interesit dhe produktit, kooperativa dhe	1. Mungesa e motivimit për ti shërbyer tokës. Koeficienti i shfrytëzimit vetëm 60%, dhe kostot e larta të punimeve me mekanikë bujqësore, si dhe inputeve bujqësore (plehra pesticide, fara, fidanë) 2. Mosfunksionimi i infrastrukturës ujëtare dhe kulluese. 3. Roli i dobët i njësive vendore të qeverisjes në koordinim burimesh, asistencë,

shoqata 7. Zhvillimi i industrisë së agropërpunimit nëpërmjet shtimit të kapaciteteve përpunuese dhe llojshmërisë së tyre.(Vitikultura dhe olivikultura) 8. Zhvillimi i Agroturiamit (oportunitet), afërsia me detin, panorama, natyra dhe cilësia e produkteve, afërsia me protein dhe aeroportin përbëjnë kushte të favorshme për këtë biznes. 9. Rritja e sipërfaqes së serave, siguron sasi më të mëdha produkti në kohë me të shkurtër dhe gjatë gjithë vitit, duke konsideruar dhe klimën e favorshme, ditët me diell gjatë vitit etj.	përfaqsim në nivelet e larta të qeverisjes 4. Mungesa e subvencioneve në mbjellje dru frutorë apo kultura të tjera. 5. Infrastruktura rrugore dhe lidhja me akset kryesore lokale e fermave dhe parcelave. 6. Vështirësitë në transportin e produktit në tregjet e shitjes. 7. Pikat e grumbullimit, limite në kapacitete, aftësi thithje të produkteve bujqësore 8. Aspektet teknologjike të kultivimit dhe sidomos mbrojtja e bimeve 9. Mungesa e formalizimit të transaksionave dhe mardhënieve tregëtare midis fermerëve dhe aktorëve të tjerë si grumbullues përpunues etj. 10. Vështirësitë në regjistrimin e tokës bujqësore në ZVRRP. Kjo pengon financimin nga sistemi bankar i projekteve që lidhen me bujqësinë. 11. Mosfunksionimi i njësive vendore në lidhje me sektorin si dhe mungesa totale e koordinimi dhe bashkëpunimi të tyre 12. Mungesa e organizimit të fermerëve në format e bashkëpunimit të njohura me ligj si kooperativat 13. Mungesa e informacionit bujqësor, përfshirë cmime, teknologji, grumbullues, përpunues etj, në tregjet e tjera kombëtare.
--	--

Pozicioni i bashkise shijak ne kontekstin rajonal

Territori i Bashkise Shijak perfshin nje siperfaqe te pergjitheshme prej rreth km2. Bashkia ka nje popullsi rreth 15000 banore, me rreth 4531 familje. I pare ne nje shkalle me te madhe, pozicioni i Bashkise dallohet per nga afersia qe ajo ka me aeroportin kryesor te vendit, me rruge kryesore interurbane dhe pozicioni ne nje territor tranzit midis Tiranës dhe Durrësit.

Bashkia ka nje pozite mjaft te favorshme ne komunikimin e afert dhe te larget me qendrat e tjera urbane te vendit fale pozicionit ne lidhje me rrjetin rrugor nacional dhe rajonal nder me kryesoret ne vend.Gjithe territori i Bashkise pershkohet nga lumi Erzen, ne nje gjatesi prej 1.7km.

Nje rendesi te vecante ka nyja rrugore (kater rruget e Shijakut) qe lidh Shijakun Komunen Xhafzotaj, Bashkine Sukth, daljen ne autostraden Tirane-Durres dhe me tej zonen e Shkozetit gjithashtu nje rruge hyrje per ne Komunen e Rrushbullit (ish stacionin zooteknik Xhafzotaj).

Bashkia perbehet nga 3 lagje :

1. Lagjia Erzen
2. Lagjia Popullore

3. Lagjia Koder

Lagjia Erzen pozicionohet ne pjesen lindore te qytetit te Shijakut, kufizohet ne lindje very jug nga Komuna Xhafzotaj dhe ne perendim nga lumi Erzen qe ben ndarjen nga dy lagjet e tjeran. Ne pjesen me lindore ka ekzistuar nje liqen qe me kalimin e kohes eshte zhdukur dhe ne pjesen me te madhe te tij eshte zene nga ndertimet informale.

Lagjia Popullore pozicionohet ne pjesen me veriore te qytetit. Ajo kufizohet ne jug nga lagjia Koder, ne veri nga Komuna Xhafzotaj, ne lindje nga lumi Erzen. Ne territorin e saj ndodhen varrezat e qytetit si dhe zona sportive.

Lagjia Koder Pozicionohet ne pjesen jugore te qytetit, ku ne veri ajo kufizohet me lagjen Popullore, ne jug ajo kufizohet me Komunen Gjepalaj si ne lindje te saj kufizohet me lagjen Erzen dhe l ndan lumi Erzen.

Gjeografia e pergjithshme e zones

Qyteti i Shijakut ndodhet ne keto pozita gjeografike:

Latitude në gradë, minuta dhe sekonda : 45° 79' 00" N

Longtitut në gradë, minuta dhe sekonda : 45° 78 00" E

Terreni eshte kryesisht fushor dhe rreth 20% kodrinor. Zona urbane eshte pjese e lugines se Erzenit. Pozita e saj gjeografike eshte mjaft e favorshme pasi ndodhet ne mes te dy qendrave me te urbanizuarave te Republikes se Shqiperise.

Kapitulli 6 : Zhvillimi ekonomik

6.1 Vështrim i përgjithshëm mbi zonën e Shijakut

Rajoni i Durrësit paraqet fuqi të shumta ekonomike; në të veprojnë rreth 8,644 ndërmarrje aktive (pa përfshirë aktivitetin privat bujqësor) duke e renditur në vendin e dytë pas rajonit të Tiranës. Pozicioni i Rajonit të Durrësit në qendër të Shqipërisë, vendosja e portit më të madh të vendit, fuqitë investuese nga dërgesat e emigrantëve dhe burimet natyrore për zhvillimin e turizmit, kanë favorizuar zhvillimin e disa sektorëve të ekonomisë rajonale dhe krijimin e një numri të madh të ndërmarrjeve aktualisht aktive.

Bashkia Shijak dhe Komunitat Xhafzotaj, Gjepalaj e Maminas, bëjnë pjesë në rrethin e Durrësit e qarkun e Durrësit. Nga pikëpamja gjeografike, të katër nëjsitë e përzgjedhura shtrihen në Shqipërinë e mesme, në zonë kodrinore e fushore, pranë ultësirës së Adriatikut. Përveç klimës të përshtatshme mesdhetare, zona përshkohet nga lumi Erzen dhe lumi Ishëm, duke siguruar kushte të përshtatshme për zhvillimin e kulturave bujqësore.

Komuna Xhafzotaj dhe Bashkia Shijak kanë popullsi më të madhe në krahasim me dy komunitet e tjera, me një dendësi rreth 100 banorë për km², afërsisht të njëjtë me dendësinë mesatare të vendit. Zona e studjuar historikisht ka qenë e ndikuar nga migracioni. Në të kaluarën e largët emigracioni i popullsisë boshnjake ndikoi në rritjen e popullsisë së zonës, ndërsa pas viteve 90-të, emigracioni i popullsisë shqiptare jashtë vendit ndikoi në ndryshimin e numrit dhe strukturën e forcave të punës.

Në zonën funksionale Shijak (Bashkia Shijak dhe Komunitet Xhafzotaj, Gjepealaj e Maminas)veprojnë 1,381 ndërmarrje aktive, rreth 16 përqind e ndërmarrjeve të të gjithë rrethit. Indeksi mesatar i PBB është më i lartë se sa i Indeksi mesatar i PBB për qarkun(0,615:0,606)¹. Sipas të njëjtit burim informacioni, edhe Indeksi mesatar i Zhvillimit Njerëzor në zonën funksionale të marrë në analizë është më i lartë se sa Indeksi mesatar i Zhvillimit Njerëzor për qarkun. (0,755:0,751). Megjithatë secila prej njësive që përbëjnë zonën funksionale Shijak, nuk demonstrojnë të njëjtin nivel të zhvillimit ekonomik, për shkak të ndikimit të faktorëve të ndryshëm.

Në të katër njësitë e përzgjedhura situata ekonomike paraqitet e vështirë, ndërsa investimet në nxitjen e punësimit, sipërmarrjen, biznesin e vogël e të mesëm si edhe infrastrukturën, të kufizuara. Bizneset e vogla dhe të mesme përbëjnë rreth 8 përqind të të gjithë bizneseve private në të katër njësitë e përzgjedhura. Ndër bizneset e mëdha, mbizotërojnë ato prodhuese, kryesisht në industrinë nxjerrëse dhe përpunuese. Shpërndarja e bizneseve private të mesme dhe të vogla është thuajse e njëjtë në të katër njësitë e përzgjedhura. Veprimtaritë ekonomike janë kryesisht të përqëndruara në sektorët e transportit, shërbimeve dhe bujqësisë, megjithëse sektori i shërbimeve zë një peshë specifike të konsiderueshme(rreth 90 përqind) në krahasim me sektorët e tjerë.

Faktorët që e bëjnë sektorin bujqësor të rëndësishëm, në zonën e Shijakut

Që prej vitit 2007, qeveritë shqiptare kanë vënë në fokus sektorin e bujqësisë , agropërpunimit, dhe zhvillimit rural, duke e shndërruar atë, në një sektor prioritar.

Kjo është arritur nëpërmjet politikave mbështetëse ndër vite, të cila kanë sjellë kalimin në një stad më të avancuar të sektorit. Tashmë mund të flitet njëkohësisht për produktivitet dhe konkurrueshmëri .

Sigurisht, kjo është shoqëruar me investime serioze në infrastrukturën rrugore, sidomos në akset kryesore ,gjë që ka përmirësuar daljen e produkteve të fermerit në treg , në periudhat përkatëse, në të gjithë territorin e vendit. (Aksesit në treg nëpërmjet një rrjeti të përshtatshëm të rrugëve kombëtare, rajonale dhe lokale, është thelbësor për sektorin e bujqësisë)

Gjithashtu marrja e statusit të vendit kandidat, ka impakt financiar të drejtpërdrejtë në sektorin bujqësor dhe agropërpunimit. Pra, është e qartë që, fondeve vjetore të buxhetit të shtetit, i shtohen dhe fondet e BE, c'ka pritet të zhvillojë më tej sektorin, në të gjitha drejtimet. Shtyllë e rëndësishme e IPA 2014-2020 është zhvillimi rural, cka do të thotë reduktim të varfërisë dhe përmirësimit të standardeve të jetesës në zonat rurale , ku bëjnë pjesë edhe katër komunitet e zonës së marrë në studim.

Zona e marrë në studim, është një zonë me potenciale të mira zhvillimi në sektorin bujqësor, që për arsye të renditura më poshtë e bëjnë këtë sektor shumë të rëndësishëm për një zhvillim të qëndrueshëm

- Pozicioni gjeografik dhe kushtet klimatike të i zonës në studim

Zona në studim pozicionohet pothuajse në mes, të aksit që lidh Kryeqytetin me Durrësin, dy metropolet e vendit. Pikërisht në këtë aks, është edhe përqendrimi më i madh i popullsisë (turizmi veror), c'ka do të thotë që ajo përfaqëson , zonën me kërkesa më të mëdha për produkte bujqësore dhe blegtorale.

¹ Strategjia e Zhvillimit të qarkut Durrës, 2005-2015, Tab. 1.17.

Klima e zonës në studim është mjaft e favorshme dhe krijon kushte optimale për prodhimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale.(Detajet për kushtet klimatike, paraqiten në studim)

- Shtrirja e zonës së studimit, sipërfaqja e punueshme dhe cilësia e tokave

Kjo zonë, kryesisht zonë fushore, ka një shtrirje të madhe. Por, duhet thënë se, sipërfaqja e lënë djerrë për zonën në studim është afërsisht 600 Ha, gati 50% e sipërfaqes së punueshme. (Arsyet e kësaj situatë shpjegohen në studim).

Dhe ky fenomen negativ është prezent , kur kjo zonë, disponon toka, që nga pikëpamja e pjellorisë, konsiderohen me pjellori natyrore , mjaft të pasura me elemente ushqyesh dhe me horizont të thellë të pjesës aktive. Përsa i përket përbërjes mekanike ato varrojnë nga toka të lehta, të mesme e deri toka të rënda.

- Shpërndarja demografike dhe përbërja e popullsisë

Sic shpjegohet edhe në studim, zona e studiuar është e përbërë nga tre komuna dhe Bashkia e Shijakut. Vihet re që në këtë zonë përqëndrimi më i madh i popullsisë është në zonat rurale (komunat e zonës në studim). Popullsia mund të konsiderohet e re, në këndvështrimin e mesatares kombëtare. Nga studimi rezulton që, kryesisht moshë e re ka pak interes për punën në bujqësi, gjë që sjell reduktim të forcave të punës dhe kontributit të tyre. Pra, politikat mbështetëse të qeverisë për sektorin dhe kushtet e reja me marrjen e fondeve të BE, mund të nxisin e motivojnë moshën e re për tu angazhuar sërish në bujqësi.

Me potencialin dhe shtrirjen e zonës, nuk përjashtohet edhe mundësia e angazhimit të krahut të punës edhe nga zonat e tjera përreth. Një fenomen tjetër me impakt mjaft pozitiv për zhvillimin e sektorit, , duket të jetë, kthimi nga emigracioni i familjeve të zonës, me fokus kryesor investimin në bujqësi, duke vënë në zbatim eksperiencën të marra nga vëndet ku ata kanë emigruar.

- Potencialet e zhvillimit të industrisë agropërpunuese

Aktualisht, sic mund të shikohet edhe në studimin e kësaj zone, industria agropërpunuese nuk është në nivele të kënaqshme. Për më tepër, ajo është e përqëndruar kryesisht në përpunimin e qumështit dhe rrushit. Megjithatë duke marrë në konsideratë numrin e fermave dhe shumëllojshmërinë e produkteve të prodhuara, kjo zonë ka një mospërputhje të madhe të potencialeve prodhuese me ato përpunuese. Zhvillimi i industrisë përpunuese, do të sillte rritje të vlerës së produkteve, rritje e shoqëruar kjo, me zhvillim të zonës dhe rritje të punësimit.

Gjatë studimit, është vënë re që, pavarësisht potencialeve, zona në studim ka shumë probleme që lidhen me sektorin. Më poshtë në mënyrë të përmbledhur paraqiten gjetjet

- Mungesa e informacionit bujqësor kryesisht për:
 - i. teknologji kultivimi,
 - ii. mbrojtja e bimëve,
 - iii. të dhënat për tregjet ku përfshihen, çmime, kërkesë ofertë,
 - iv. asistencë e duhur në përdorimin e inputeve, teknologji ruajtje dhe përpunimi etj
- Mungesa e prezencës së strukturave përgjegjëse shtetërore në sigurimin e funksionimit të infrastrukturës së kullimit ujë.
- Mungesa e subvencionimeve (sidomos dy vjeçarit e fundit)

- Mungesa e tregjeve, mosfunionimi i tyre (Xhafzotaj) apo infrastruktura e dobët kur ato funksionojnë (Shijak).
- Rritja e kostove për shkak të transportit në tregjet jashtë zonës së studimit, si edhe cilësia e dobët e ofruesve të këtij shërbimi.
- Indiferenca e njësive vendore të qeverisjes kundrejt sektorit. Njësitë vendore nuk përfaqësojnë fermerët në nivelet e qeverisjes qendrore. Momentalisht reforma teritoriale duke ndryshuar organizimin e komunave nga njëra anë ul ndikimin e njësive vendore në rajon por nga ana tjetër bashkimi në një njësi vendore mund të sjellë një koordinim më të mirë dhe adresim e zgjidhje më të mirë të problemeve si psh vënia në efencencë e tregjeve, përmirësimi i infrastrukturës rrugore etj.
- Shfrytëzim në nivel të ulët i burimeve natyrore (toka), zhvillim i ulët i industrisë përpunuese dhe sektorit të shërbimeve si agroturizmi.

Situata e sektorit bujqësor

Sektori i bujqësisë në vitet e fundit është kthyer në sektorin më të rëndësishëm në ekonominë e mbarë vendit. Kjo për disa arsye, ku vlen të përmenden i) përqëndrimi i popullsisë në zonat rurale ii) tradita në sektor dhe iii) niveli i ulët i zhvillimit të sektorit.

Mbarëvajtja e këtij sektori për ekonominë përkthehet në rritje ekonomike, punësim, mirëqenie dhe zhvillim dhe të sektorëve të tjerë të lidhur si industria e përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale turizmi etj. Duke qënë se është një sektor në zhvillim në përgjithësi produktet shqipëtare në një pjesë të madhe të territorit prodhohen akoma në mënyrë natyrale cka i bën këto produkte konkurruese në tregun ndërkombëtar, duke ndikuar pozitivisht dhe drejtpërsëdrejti në rritjen e eksporteve dhe për pasojë edhe në bilancin tregtar të vendit.

Këto janë disa nga arsyet që kanë orientuar qeveritë shqiptare të kthejnë vëmendjen nga sektori i bujqësisë dhe industrive të lidhura me to. Për rrjedhojë janë hartuar politika bujqësore për të nxitur prodhimin nëpërmjet subvencionimit të mbjelljeve të ullirit, pemëve frutore dhe rritjes e mbarështimit të gjedhit të imtave dhe dërrit. Politikat orientuese të ekzekutivit janë bazuar në studime të detajuara për kultura si ulliri, pemët frutore dhe arrorëve gjë që ka cuar në rritjen e sipërfaqes së kultivuar me këto kultura, madje rezultatet e para kanë filluar të ndjehen.

Vlejnë për tu përmendur disa histori suksesi si psh:

- a) kultivimi i agrumeve në Sarandë komuna xarrë, ku dominon kultivimi i mandarinës,
- b) krijimi i fermave të mëdha të mbarështimit të gjedhit me përqendrim në rajonet si Durrësi, Lushnja, Fieri, Berati, Korca e Shkodra si dhe
- c) mbarështimi i të imtave në zonat malore të vendit, ku afërsisht sipas të dhënave të Ministrisë së Bujqësisë numërohen rreth 4 milionë krerë, bimët medicinale që kultivohen kryesisht në rajonin e Shkodrës i cili plotëson rreth 70% të sasisë së eksportuar prej 4000 ton/vit etj.

Qeveritë shqiptare duke filluar nga 2007 kanë subvencionuar sektorin me afërsisht 10 milionë USD në vit, ndërkohë që nevoja e sektorit ka qënë mesatarisht 3-4 herë më shumë. Sipas Ministrisë së Bujqësisë nevojat reale për subvencione për 2015 janë afërsisht 50 milionë USD. Krahasuar me rajonin kjo shifër është 2 herë më e vogël por mbetet e pa përballueshme nga buxheti i qeverisë shqiptare. Me marrjen e statusit të vendit kandidat

fondet për sektorit rriten ndjeshëm, por në të njëjtën kohë problem duket të jetë aftësia thithëse e sektorit për shkak të kushteve dhe kriterëve të kërkuara për përfitim.

Referuar të dhënave të INSTAT, numri i fermave në shkallë vendi është 380 mijë dhe popullsia që banon në zonat rurale është 50% e popullsisë së vendit.

Pavarsisht zhvillimeve të sektorit të përmendura më sipër, problematika është ende e qënësishme dhe e natyrave të ndryshme cka bën të vështirë shprehjen e potencialit real të sektorit në vend.

Më poshtë në mënyrë të përmblodhur po paraqesim disa prej tyre .

Problematika e tokave bujqësore

Fondi i tokës bujqësore prej 695 mijë ha dhe zë rreth 24% të të gjithë territorit të vendit tonë. Aktualisht nga sipërfaqja e përgjithshme e saj 561 mijë ha ose 80% është në pronësi private dhe 134 mijë ha ose 20% është në pronësi shtetërore.

Reforma e privatizimit të tokës bujqësore është një nga reformat me të mëdha në fushën e transformimit të drejtave të pronësive të kryera në vendin tonë pas viteve '90. Nepermjet saj u bë e mundur krijimi i fermave private dhe siguri i mjeteve të domosdoshme të jetesës për shumicën e popullsisë rurale të vendit;

Nga privatizimi i tokës bujqësore rezultoi krijimi i një numri të madh fermash/ekonomi bujqësore, por me një sipërfaqe mesatare të tokës shumë të vogël dhe për më tepër, me fragmentim shumë të madh (3-6 parcela për fermë). Levizjet e pakontrolluara të një pjese të popullsisë rurale drejt zonës së ulët të vendit dhe kryesisht në periferitë e qyteteve të mëdha u shoqëruan edhe me zaptimin e tokave bujqësore dhe një numër të madh ndërtimeve informale, që kanë zvogëluar faktikisht sipërfaqen e tokës bujqësore. Mungesa, zbatimi jo korrekt i planeve të zhvillimit të territorit ka ndikuar negativisht në mbrojtjen e fondit të tokës bujqësore.

Për të adresuar efektet e privatizimit të tokës bujqësore, që rezultoi në krijimin e një numri shumë të madh fermash, por me sipërfaqe të vogël dhe fragmentarizim të shkajshëm të tokës, është përgatitur një draft strategji kombëtare afatgjate të konsolidimit të tokës. Strategjia parashikon krijimin e një njesie të veçantë për konsolidimin e tokës në ministri, hartimin e kuadrit ligjor, implementimin e një programi kombëtar afatgjate për konsolidimin e tokës bujqësore, mekanizmat e financimit etj.

Probleme në sistemin e kullimit dhe ujitjes

Menaxhimi i Burimeve Ujore është i lidhur ngushtë me mbështetjen e rritjes së qendrueshme ekonomike të sektoreve që përdorin dhe shfrytëzojnë ujë (bujqësia e ujëtrajtuese, industria, turizmi, prodhimi i energjisë elektrike) dhe mirëqenien sociale të popullit (furnizimi me ujë, reduktim i varfërisë etj).

Ujitja dhe kullimi janë një nga faktorët e rëndësishëm me ndikim të drejtperdrejtë në rritjen e qendrueshme të prodhimit bujqësor në vend. Shërbimi i ujitjes dhe kullimit është ende larg të qenit në parametra optimale. Për këtë arsye, përmirësimi i menaxhimit të tyre bëhet domosdoshëm ndërmarrjen e veprimeve të menjëhershme.

Megjithese Shqipëria është e favorizuar me burime ujore dhe rreshje mesatare vjetore rreth 1485 mm, fakti që rreth 20% të totalit të reshjeve bien në periudhën e verës, e bën të domosdoshme nevojën për ujitje gjatë periudhës së verës (që varion nga 300-500 mm ose 3000-5000 m³/ha) dhe garantimin e kullimit (largimin e ujerave) e mbrojtjen nga permbytjet gjatë periudhës së dimrit, me një hidromodul rreth 4-5 litra/sek/ha. Permbytjet janë një fenomen që perseritet shpesh, veçanërisht në periudhën nëntor-mars. Zona me e rrezikuar nga permbytja është ultësira perëndimore, pasojë e rrjedhjes së lumenjve nga lindja në perëndim të vendit.

Aktualisht, për shkak të gjendjes së infrastruktures së ujitjes dhe menaxhimit të dobët nuk plotësohen në kohë dhe sasi nevojat e fermerëve për ujitje. Nga deficieti i ujitjes prej 300-500 mm gjatë sezonit të verës, është arritur të plotësohen mesatarisht, në varësi edhe nga kushtet e motit, rreth 200 mm.

Menaxhimi i ujitjes me pjesëmarrje, nepermjet shpu-ve, i suportuar për gati 15 vjet nga projektet e Bankës Botërore, tregon se kjo formë menaxhimi përgjithësisht nuk rezultoi e pershtatshme dhe adekuate për kushtet konkrete të vendit tonë. Kjo edhe për faktore të tilla si mungesa e traditës kooperuese dhe përvojat negative të mëparshme, mungesa e besimit dhe kohezionit social etj.

Ndërkaq reforma e decentralizimit dhe fuqizimi i rolit të komunave/bashkive (K/B) në dhjetë vitet e fundit, kanë treguar se ky nivel qeverisës ka krijuar legjitimitet dhe besim publik, kapacitete në rritje qeverisëse, performance në rritje në lehtësimin e shërbimeve publike vendore si dhe rritje të kapaciteteve të burimeve fiskale. Synimi në një plan me afatgjatë është që subvencionimi i shtetit për mirëmbajtjen e infrastruktures kryesore ujëtare të zvogëlohet, krahas rritjes graduale të kontributit të përfituesve.

Kullimi dhe mbrojtja nga përmbytja

Në ultësirën perëndimore të vendit, evidentohen permbytje të shpeshta gjatë periudhës me reshje vjesht-dimër, pasojë e mosfunksionimit të kapacitetit të plote të rrjetit të kanaleve kullues dhe stacioneve të pompimit të kullimit (hidrovore). Nga moslargimi ciklik i dherave nga rrjeti i kanaleve kullues është emergjente zhvendosja e rreth 15 milionë m³ materiale të ngurta. Ndërsa hidrovoret kanë nevojë për rritjen e kapacitetit dhe modernizimin e tyre.

Panvaresisht ndërhyrjeve të bëra për mirëmbajtjen e argjinaturave lumore dhe detare, për shkak të mirëmbajtjes së kufizuar, shfrytëzimit pa kriter të inerteve në shtreterit të lumenjve, fenomeneve të pazakonta të shfaqura në vitet e fundit me sasi dhe intensitet të madh reshjesh, rehabilitimi dhe rikonceptimi i sigurisë së tyre është më se i domosdoshëm. Përgjatë brigjeve të lumenjve janë evidentuar gërryerje dhe demtime edhe të tokave bujqësore. Problematike paraqitet siguria e digave të rezervuareve që përdoren për ujitje.

Struktura e fermës

Përmasa e fermës është rritur nga 1,14 ha në 1,26 ha nga viti 2007 deri në vitin 2011, ndërkohë që përmasa e parcelës ka mbetur e pandryshuar (0,27 ha), duke nënkuptuar jo

vetëm madhësi të vogël të fermës, por edhe nivel të lartë të fragmentimit, i cili karakterizon sektorin bujqësor në Shqipëri.

Konsolidimi i madhësisë së fermës përbën një prirje pozitive, por ende të ngadaltë dhe larg nivelit të nevojshëm që një familje të ketë të ardhura të mjaftueshme nga fermat dhe larg nga mesatarja e BE-së. Ritmi më i shpejtë dhe më i lartë i rritjes së madhësisë së fermës është i nevojshëm për të përmirësuar efikasitetin ekonomik në prodhimin bujqësor në shumicën e nënsektorëve, për t'u bërë më konkurrues krahasuar me vendet e tjera në rajon.

Tregjet

Problematika kryesore e tregjeve konsiston në i) largësinë e tyre nga ferma ii) infrastruktura e shërbimeve që ofrohen në to si edhe iii) mungesa e informacionit të shpejtë dhe të saktë për cmimet dhe sasi të mallrave. Problem tjetër është edhe administrimi i tregjeve nga strukturat shtetërore, kryesisht qeverisja vendore, gjë që ndikon drejtpërsëdrejti në performancën e tregjeve. Pavarësisht përmirësimit të infrastrukturës rrugore, shumë zona e kanë të vështirë aksesin me tregjet për shkak edhe të kushteve të transportit dhe kostos së lartë të tij.

Për më tepër transaksionet janë në pjesën më të madhe rastësore dhe mungon pothuajse plotësisht koordinimi i kërkesës me ofertën para daljes së produkteve në treg .

Nga një studim i bërë rezulton që për sektorin mungon një sistem informacioni bujqësor që do të mundësonte dhe ndihmonte fermerin në drejtim të teknologjive të prodhimit dhe promovimit dhe shitjes të produkteve të tyre.


Ecuria e sektorit gjatë viteve 2006-2014

Më poshtë jepen të dhënat statistikore për zonën e studimit që prej vitit 2006. Këto statistika janë marrë nga Ministria e Bujqësisë dhe tregojnë më së miri tendencën e zhvillimit të bujqësisë në zonën e studiuar për sa i takon numrit të fermave dhe llojit të tyre, potencialet prodhuese në vite, afërsia me tregjet e zonës dhe tregjet rajonale, grumbulluesit dhe përpunuesit në zonë. Pra tabelat e mëposhtme tregojnë ecurinë dhe ndërveprimin e një pjese të mirë të aktorëve të sektorit.

Të dhënat për fermat dhe grafiku përkatës:

Viti	Nr	Komune/Bashki	Nr tot i fermave	Ferma bujqesore	Ferma Blegtorale	Ferma mixe
2006	1	Shijak	139	14	15	110
	2	Xhafzotaj	2611	766	545	1300
	3	Maminas	1255	40	15	1200
	4	Gjepalaj	1086	16	140	930
	Totali		5091	836	715	3540
2007	1	Shijak	135	10	18	107
	2	Xhafzotaj	2580	750	550	1280
	3	Maminas	1278	40	15	1223
	4	Gjepalaj	1052	12	134	906
	Totali		5045	812	717	3516

	1	Shijak				
	2	Xhafzotaj	2672	780	562	1330
	3	Maminas	1292	46	18	1228
	4	Gjepalaj	1092	16	146	930
	Totali		5211	852	745	3614
2009	1	Shijak	154	10	24	120
	2	Xhafzotaj	1416	750	530	136
	3	Maminas	1319	35	17	1267
	4	Gjepalaj	1110	16	124	970
	Totali		3999	811	695	2493
2010	1	Shijak	148	20	18	110
	2	Xhafzotaj	2470	760	530	1180
	3	Maminas	1332	46	26	1260
	4	Gjepalaj	1084	14	140	930
	Totali		5034	840	714	3480
2011	1	Shijak	148	20	18	110
	2	Xhafzotaj	2470	760	530	1180
	3	Maminas	1332	46	26	1260
	4	Gjepalaj	1084	14	140	930
	Totali		5034	840	714	3480
2012	1	Shijak	181	28	23	130
	2	Xhafzotaj	2410	800	500	1110
	3	Maminas	1335	45	23	1267
	4	Gjepalaj	1051	16	145	890
	Totali		4977	889	691	3397
2013	1	Shijak	181	28	23	130
	2	Xhafzotaj	2410	800	500	1110
	3	Maminas	1335	45	23	1267
	4	Gjepalaj	1051	16	145	890
	Totali		4977	889	691	3397
2014	1	Shijak	150	10	19	121
	2	Xhafzotaj	2638	765	562	1311
	3	Maminas	1280	42	18	1220
	4	Gjepalaj	1101	16	146	939
	Totali		5169	833	745	3591




Numri total i fermave në vite varion nga 4,500-5,500 ferma. Rreth 60% e tyre janë ferma bujqësore e blegtorale (mikse) ku fokus kryesisht mbetet bujqësia. Arsyeja e mbizoterimit të ketyre lloj fermave është qellimi, se pari i plotësimit të nevojave familjare për këto produkte dhe me pas tregëtimi i sasive të mbetura. Fermat kryesisht shfrytëzojnë punën e anëtarëve të familjes për shkak të madhësisë relativisht të vogël të fermave.

Tabela për tregjet në zonën e studimit

Viti	Nr	Komune/Bashki	Numri i Tregjeve	Treg bujqesor	Treg Blegtoral	Tregje mixe
2006-2013	1	Shijak	3	1	1	1
	2	Xhafzotaj	0	0	0	0
	3	Maminas	0	0	0	0
	4	Gjepalaj	0	0	0	0
	Totali		3	1	1	1
2014	1	Shijak	3	1	1	1
	2	Xhafzotaj	1	1	1	1
	3	Maminas	0	0	0	0
	4	Gjepalaj	0	0	0	0
	Totali		4	2	2	2

Grafiku për tregjet



Sa i takon tregjeve në zonën e studimit, gjatë vizitave në terren doli qartë fakti që ato janë jo funksionalë. Konkretisht në Shijak, tregu organizohet në dy anët e rrugës hyrëse të qytetit, spontanisht dhe në kuadër të një tradite: dita e tregut është e diela. Cdo fermer shet produktet e veta qofshin këto blegtorale apo bujqësore. Ndërkohë që në vitin 2004, me kontribut të FAO, në Gjepalaj është ngritur një strukturë e mirëorganizuar në infrastrukturë dhe hapësira të konsiderueshme, por që nuk ka funksionuar asnjë ditë dhe momentalisht e braktisur dhe jashtë funksionit. Kjo sipas fermerëve të zonës ka ndodhur pasi pozicionimi i tij ishte i gabuar, larg komunave Maminas e Gjepalaj dhe fare pranë me tregun e Durrësit. Pra kjo ka penalizuar zonën e studimit pasi për shkak të shtrirjes së zonës për maminasin dhe gjepalajn ka qënë më e lehtë tregëtimi në tregjet e Tiranës.

Fotot e tregut Xhafzotaj 10.12.2014



Tabela për grumbulluesit

Viti	Komune/Bashki	Nr. total i grumbulluesve	Grumbullues të produkteve bujqësore	Grumbullues të produkteve blegtorale	Grumbullues të produkteve (mikse)
2006 - 2009	Shijak	2		2	
	Xhafzotaj	3		3	
	Maminas	2	1	1	
	Gjepalaj			2	
2009	Totali	7	1	8	
2010 -	Shijak				

2013	Xhafzotaj			
	Maminas	2	1	1
	Gjepalaj	2	1	1
	Totali	4	2	2
	Shijak	2		2
	Xhafzotaj	3		3
	Maminas	2	1	1
	Gjepalaj			2
2014	Totali	7	1	8

Sa i takon grumbulluesve në zonën e studimit operojnë momentalisht 8 të tillë. Kryesisht grumbullojnë produktet bujqësore. Ndërkohë që së fundmi ka iniciativa për ngritjen e kantineve të verës sidomos në komunën e Maminasit ku kjo kulturë bashkë me ullirin janë kulturat prioritare. Referuar potencialeve prodhuese të zonës keto pika frumbullimi janë të pamjaftueshme në kapacitete dhe numër. Marrdhëniet midis aktorëve janë të paformalizuara nga ana ligjore (pa kontrata). Këto kushte detyrojnë fermerin të shkojë individualisht në tregjet më pranë tij (Tiranë Durrës), cka në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon në kostot e tyre. Transporti dhe infrastruktura rrugore në brendësi të komunave lënë shumë për të dëshiruar.

Tabela e bizneseve te agropërpunimit

Viti	Komune/Bashki	Nr. total i përpunuesve	Përpunues të produkteve bujqësore	Përpunues të produkteve blegtorale	Përpunues të produkteve (mikse)
2006	Shijak				
	Xhafzotaj				
	Maminas				
	Gjepalaj				
	Totali				
	Shijak	2		1	1
2007-2009	Xhafzotaj	4	4		
	Maminas				
	Gjepalaj				
	Totali	6	4	1	1
	Shijak	2		1	1
	Xhafzotaj				
2010-2013	Maminas				
	Gjepalaj				
	Totali	2		1	1
	Shijak	2		1	1
2014	Xhafzotaj	4	4		

		Maminas				
		Gjepalaj				
	Totali	6	4	1	1	

Tabela e potencialeve prodhuese 2006-2009

Viti	Nr	Produkti	B.Shijak	Xhafzotaj	Maminas	Gjepalaj
2006 2007	1	Fruta		100	750	20
	2	Perime		1800	3193	80
	3	Ullinj			617	15
	4	Vreshte			1411	201
	5	Agrume		200	238	
	6	Mish		100	196	
	7	Qumesht	30	200	2759	1200
	8	Veze 000/kokrra		5600	1732	
	9	Mjalte		1	5.8	
2008	1	Fruta		80	730	24
	2	Perime		1750	3200	90
	3	Ullinj			550	20
	4	Vreshte			1450	220
	5	Agrume		230	230	
	6	Mish		120	185	
	7	Qumesht	30	260	2765	1234
	8	Veze 000/kokrra		5450	1700	
	9	Mjalte		1	5.8	
2009	1	Fruta		110	700	18
	2	Perime		1670	3000	60
	3	Ullinj			610	14
	4	Vreshte			1380	210
	5	Agrume		198	245	
	6	Mish		130	204	
	7	Qumesht	30	198	2700	1200
	8	Veze 000/kokrra		6000	1800	
	9	Mjalte		1	5.8	

Tabela e potencialeve prodhuese 2009-2014

Viti	Nr	Produkti	B.Shijak	Xhafzotaj	Maminas	Gjepalaj
2010	1	Fruta		100	750	20
	2	Perime		1800	3193	80
	3	Ullinj			617	15
	4	Vreshte			1411	201

	5	Agrume		200	238	
	6	Mish		100	196	
	7	Qumesht	30	200	2759	1200
	8	Veze 000/kokrra		5600	1732	
	9	Mjalte		1	5.8	
	1	Fruta		90	750	20
	2	Perime		1670	3109	80
	3	Ullinj		30	605	15
	4	Vreshte		150	1410	230
2011	5	Agrume		270	260	
	6	Mish		160	187	
	7	Qumesht	30	234	2800	1200
	8	Veze 000/kokrra		5600	1732	
	9	Mjalte		1	5.8	
	1	Fruta		120	780	30
	2	Perime		1700	3200	100
	3	Ullinj		30	620	15
	4	Vreshte		140	1390	230
2012	5	Agrume		240	250	
	6	Mish		180	190	
	7	Qumesht	30	234	2800	1200
	8	Veze 000/kokrra		5500	1700	
	9	Mjalte		1	5.8	
	1	Fruta		110	760	30
	2	Perime		1600	3200	100
	3	Ullinj		30	620	15
	4	Vreshte		140	1390	230
2013	5	Agrume		230	200	
	6	Mish		150	170	
	7	Qumesht	30	230	2600	1200
	8	Veze 000/kokrra		5550	1650	
	9	Mjalte		1	5.8	
	1	Fruta		100	750	20
	2	Perime		1800	3193	80
	3	Ullinj			617	15
	4	Vreshte			1411	201
2014	5	Agrume		200	238	
	6	Mish		100	196	
	7	Qumesht	30	200	2759	1200
	8	Veze 000/kokrra		5600	1732	
	9	Mjalte		1	5.8	

Sa i takon potencialeve prodhuese, nga ecuria në vite rezulton se Shijaku është zona me potencialet më të vogla të prodhimit kjo dhe për vetë natyrën e zonës. Ajo është qendra e zonës dhe ka natyrën dhe zhvillimin tipik të një qyteti. Tre komunat e tjera, kanë potenciale prodhimi që plotësojnë nevojat e popullsisë së zonës madje dhe një pjesë të nevojave të tregjeve rajonale, Tiranë-Durrës. Mungesa e formalizimit të shkëmbimeve tregëtare ndikon drejtpërdrejt në potencialin prodhues dhe orientimin drejt produkteve të duhuara.

Duke mos pasur të kontraktuar sasinë e produktit në avancë, planifikimi dhe motivimi për tu “rritur” i fermerëve është shumë i ulët. Nga tabela del qartë që potencialet prodhuese janë thuajse lineare gjatë gjithë periudhës për të cilën janë mbledhur të dhënat. Gjithashtu, vlen të përmendet që koeficienti i shfrytëzimit të tokës në dispozicion nuk është më i madh se 60%. Për cdo komunë ka rreth 200 Ha tokë të lënë djerrë. Kjo ndikon drejtpërsëdrejti dhe në ecurinë dhe zhvillimin e industrisë agropërpunuese që operon në zonë. Ato përveç kapaciteteve të ulta përpunuese në shumë raste punojnë në mënyrë sezonale. Në përgjithësi kjo zonë ka përfituar shumë pak edhe nga subvencionet, shkak edhe politikat e qeverisjes në kuadër të alokimit të fondeve sipas rajoneve.

Në përgjithësi rajoni i Durrësit ku bën pjesë dhe zona e studimit, është renditur gjithmonë në rajonet që kanë përfituar me pak me një mesatere prej deri në 2012 prej 200,000 USD, ndërkohë që për vitin 2014 planifikimi për rajonin e Durrësit është afërsisht 8 mil lekë, apo 80,000 USD. Kjo një shifër e papërfillshme krahasuar me nevojat e sektorit. Vetëm Zona e studimit për 2014 numëron rreth 5500 ferma, që janë potenciale për aplikim për të përfituar nga program i qeverisë për mbështetjen e fermerëve.

Analiza SWOT për zonën e studimit

Pikat e forta dhe mundësitë	Pikat e dobëta dhe kërcënimet
10. Pozicioni gjeografik 11. Kushtet klimatiko - tokësore 12. Tradita në kultivimin e vreshtave, ullinjeve, perimeve 13. Afërsia me tregjet e Tiranës dhe Durrësit 14. Sasia e tokës së pa punuar, në dispozicion (oportunitet) 15. Mundësia për krijimin e grupeve sipas interesit dhe produktit, kooperativa dhe shoqata 16. Zhvillimi i industrisë së agropërpunimit nëpërmjet shtimit të kapaciteteve përpunuese dhe llojshmërisë së tyre.(Vitikultura dhe olivikultura) 17. Zhvillimi i Agroturiamit (oportunitet), afërsia me detin, panorama, natyra dhe cilësia e produkteve, afërsia me protein dhe aeroportin përbëjnë kushte të favorshme për këtë biznes.	14. Mungesa e motivimit për ti shërbyer tokës. Koeficienti i shfrytëzimit vetëm 60%, dhe kostot e larta të punimeve me mekanikë bujqësore, si dhe inputeve bujqësore(plehra pesticide, fara, fidanë) 15. Mosfunksionimi i infrastrukturës ujitëse dhe kulluese. 16. Roli i dobët i njësive vendore të qeverisjes në koordinim burimesh, asistencë, përfaqsim në nivelet e larta të qeverisjes 17. Mungesa e subvencioneve në mbjellje dru frutorë apo kultura të tjera. 18. Infrastruktura rrugore dhe lidhja me akset kryesore lokale e fermave dhe parcelave. 19. Vështirësitë në transportin e produktit në tregjet e shitjes. 20. Pikat e grumbullimit, limite në kapacitete, aftësi thithje të produkteve bujqësore 21. Aspektet teknologjike të kultivimit dhe

18. Rritja e sipërfaqes së serave, siguron sasi më të mëdha produkti në kohë me të shkurtër dhe gjatë gjithë vitit, duke konsideruar dhe klimën e favorshme, ditët me diell gjatë vitit etj.	sidomos mbrojtja e bimeve 22. Mungesa e formalizimit të transaksionave dhe marrëdhënieve tregëtare midis fermerëve dhe aktorëve të tjerë si grumbullues përpunues etj. 23. Vështirësitë në regjistrimin e tokës bujqësore në ZVRRP. Kjo pengon financimin nga sistemi bankar i projekteve që lidhen me bujqësinë. 24. Mosfunksionimi i njësive vendore në lidhje me sektorin si dhe mungesa totale e koordinimit dhe bashkëpunimit të tyre 25. Mungesa e organizimit të fermerëve në format e bashkëpunimit të njohura me ligj si kooperativat 26. Mungesa e informacionit bujqësor, përfshirë cmime, teknologji, grumbullues, përpunues etj, në tregjet e tjera kombëtare.
--	---

Kapitulli 7 : Analiza dhe vlerësimi i problematikave sociale

Varferia në Shijak ka karakteristika të ndryshme, por predominon në zonën rurale. Ajo përmbledh disa dimensione si: (a) niveli i ulët apo shumë i ulët i të ardhurave të të varfërve; (b) rreziku i lartë nga semundjet dhe mungesa e shërbimeve të pershtatshme shëndetësore; (c) analfabetizmi dhe niveli i ulët i shkollimit; dhe (d) akses i kufizuar në institucionet vendim-marrëse qeveritare. Vdekshmëria foshnjore dhe vdekshmëria tek fëmijet nën moshën pesë vjeç, është ende shqetësuese, dhe pothuaj një në çdo dhjetë fëmijë nën moshën pesë vjeç, është i keqshqyer. Analfabetizmi është rritur; dhe tre të katërtat e familjeve të varfëra përjetojnë probleme të forta sociale.

Mundësia e të jetuarit në varfëri rritet paralel me rritjen e madhësisë së familjes. Nivelet e varfërisë janë relativisht të larta në ato grupe, për të cilat bujqësia është burimi kryesor i të ardhurave. Kjo përforcohet nga fakti që shumica e të varfërve janë fermerë, pensionistë, persona me aftësi të kufizuara, persona të punësuar në sektorin jobujqësor. Në shumë familje, në të cilat kryefamiljari është i papunë, jeton në nivelin e varfërisë. Pavarësisht nga reformat e lavdërueshme që janë kryer, një numër jo i vogël problemesh kanë mbetur pa u zgjidhur, pa u prekur nga reformat që janë zbatuar deri më sot ose që janë lënë menjëherë nga zhvillimi ekonomik në nivel vendor. Disa me tipiket prej tyre janë mosrespektimi i plotë i ligjeve të aprovuara, shfaqja e korrupsionit, i cili minon reformat dhe mungesa e transparencës, paafesia e zonave të caktuara brenda territorit aktual për t'u përshatatur me një mjedis në ndryshim, duke shkaktuar një rritje në disnivelet e zhvillimit kohëzive të territorit.

Zona rurale përballë me probleme serioze të furnizimit me ujë dhe higjienës. Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë dhe higjienës përben një nga faktorët kryesorë për përmirësimin e kushteve shëndetësore. Problemet kryesore janë: (a) degradimi i

rrjetit fizik, (b) mbik konsumimi si rezultat i përdorimit të ujit të pijshëm për bujqesinë, (c) mungesa e kontrollit mbi konsumin faktik përfshirë çmimin e ujit dhe nivelin e ujit të faturimit, (d) institucione jo të konsoliduara që merren me furnizimin me ujë, dhe (e) mungesa e një strategjie për të përmirësuar shërbimet. Përmirësimet në zonat rurale lidhen ngushtesisht me procesin e decentralizimit, i cili e kalon përgjegjësinë e furnizimit me ujë tek pushteti vendor. Bashkia synon të ndërtojë një program efektiv pune për furnizimin me ujë dhe higjienën në zonën rurale, i cila synon të ndryshojë mënyrën sesi realizohet furnizimi me ujë në Shijak. Roli i qeverisë duhet të jetë të mbështetë kuadrin e ri institucional dhe të sigurojë kuadrin rregullator të nevojshëm që garanton pjesëmarrjen e strukturave vendore dhe komunitare në menaxhimin dhe vendimmarrjen në lidhje me furnizimin me ujë të pijshëm.

Me qëllim uljen e paparazive brenda territorit të bashkisë dhe të efekteve të problematikës së cituar më sipër, praktika evropiane na mëson se përfitimet nga një orientim më i mirë i punësimit, aftësive dhe politikave ekonomike janë në rritje më të dukshme në kontekstin e një ekonomie lokale të dijes. Po ashtu, një nga avantazhet kryesore që bashkia mund t'i ofrojë çdo biznesi është cilësia e kapitalit njerëzor. Në njohje të saj, nëpunësit e zhvillimit ekonomik dhe urban në bashki mund të përfitojnë dukshëm nëse bashkëpunojnë me zyrën, agjensitë e punësimit duke e përdorur zhvillimin e forcës së punës si një instrument për të tërhequr kompani, ndërmarrje të reja dhe për të nxitur njëkohësisht zhvillimin ekonomik lokal.

Në të njëjtën kohë, vendimmarrësit në politikën e punësimit janë mjaft të varur nga aktorët vendorë në arritjen e objektivave të tyre strategjike. Nxitja e përmirësimit të cilësisë së jetës si një mjet tërheqës and ruajtës të një force pune të kalibrit të lartë po bëhet edhe në Shqipëri një mjet i rëndësishëm për zhvillimin e tregut lokal të punës. Ofruesit e trajnimeve përfitojnë nga komunikimi i qëndrueshëm me agjentë të zhvillimit ekonomik dhe biznese vendore duke u siguruar se kurset e trajnimit reflektojnë shpejt ndaj kërkesave në zhvillim për aftësi dhe përgatitje aktorët vendorë për investimet e pritshme. Veç sa më sipër, shumë prej barrierave që krijojnë përjashtim afat-gjatë nga tregu i punës (mungesë qasjeje në shërbime transporti, dhe të mirëqënies/lehtësimit për fëmijët, probleme shëndetsore të akumuluar) kërkojnë ndërhyrje që përshkojnë një numër të caktuar të politikave që duhet të shqyrtohen.

Ndërsa sigurohemi që politikat e punësimit, aftësimit ndërlidhen me zhvillimin ekonomik lokal përballojmë një sfidë jo të vogël. Megjithatë, kjo nuk është e mundur nëse nuk përfshijmë në proces një listë të gjerë të aktorëve vendorë që punojnë për strategji dhe partneritete të shumta po në nivel lokal. Zyrat e punës, agjensitë e zhvillimit ekonomik dhe agjensitë e formimit profesional punojnë në një skenar tipik pa u ndërlidhur me njëra-tjetrën. Por ndarje të tilla shpesh merren si të mirëqëna duke u shfajësuar se mardhëniet ndërmjet strukturave lokale kanë qënë gjithmonë të tilla. Megjithatë përvoja e dokumentuar në mjaft vende të Evropës na konfirmon se barrierat të tilla mund të reduktohen duke injektuar më shumë fleksibilitet në menaxhimin e politikave dhe në zbatimin e skemave më efektive të qeverisjes vendore.

Nëpërmjet partneriteteve dhe strategjive të integruara/bashkërenduara mund të

arrihet në arritjen e zgjidhjeve efektive të problemeve të ndryshme vendore, veçanërisht aty ku zyrat e punësimit dhe të formimit profesional kanë fleksibilitetin e nevojshëm për të përshtatur politikat dhe programet në ndjekje të objektivave të partneritetit. Metodat bashkëpunuese janë ndoshta më efektive kur bazohen në një dokumentacion të përbashkët të dhënave lokale që rishikohen periodikisht, të cilat nga ana tjetër ndërtojnë një bazë mjaft të fortë për monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit të politikave.

Ndërsa partneritetet e formalizuara mund të jenë platforma të dobishme për të miratuar një veprim dhe strategji të përbashkët, ekziston rreziku që ato të ‘institucionalizohen’ padashje dhe të fokusohen më shumë në procese sesa në arritjen e rezultateve për të cilat u krijuan. Komunikimi i vazhdueshëm informal ndërmjet organizatave, aktorëve dhe instituconeve lokale në disa raste mund të rezultojë më efektiv në ndërtimin e kapitalit social lokal, duke reduktuar kostot e ndërveprimit dhe instaluar një vullnet për t’u përballur dhe gjetur zgjidhje për sfidat e përditshme. Jacobs (1984) e identifikoi zhvillimin ekonomik vendor si një ‘proces të pafund të improvizimit të vazhdueshmëm në një kontekst që i bën improvizimet e injektuara të realizueshme në jetën e përditshme’. Është e qartë se jo nuk janë vetëm individët që duhet të improvizojnë vazhdimisht por edhe vendimmarrësit lokalë, duke punuar në partneritet në zgjidhjen e çështjeve me interes të përgjithshëm. ‘Ndërmjetësuesit lokalë’ mund të jenë mjaft të dobishëm në mbështetjen e një konsultimi dhe bashkëpunimi të qëndrueshëm për zhvillimin lokal.

Kapitulli 8 : Analiza e zhvillimit social, punësimin, edukimin, shëndetin etj.

ANALIZA EKONOMIKO - SOCIALE

Aktivitetet ekonomike në Bashkinë Shijak zënë një game relativisht të gjërë, duke u shtrirë nga bizneset tradicionale për një zonë rurale, në objekte të industrisë së lehtë e deri diku të rënda (impante të përpunimit të bitumit).

Sipërmarrjet

Rritja e shpejtë e popullsisë së zonës ka filluar pas viteve 90’ dhe vazhdon me ritme më të ulëta, duke dominuar shtimi i banesave dhe i bizneseve të reja, gjë e cila ka çuar në një urbanizim të shpejtë veçanërisht të territoreve rurale. Për të patur një parashikim sa më real për perspektivën e Bashkisë së Shijakut është e nevojshme analizimi i situatës aktuale dhe njohja e mundësive për një zhvillim sa më të drejtë. Situata ekzistuese për bizneset në zonë e pasqyrojnë tablën e mëposhtme.

Familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike nga shteti

Muaj/ Vite	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Janar	376	334	295	224	199	170	161	171
Shkurt	377	333	288	232	192	167	163	163
Mars	375	328	285	222	188	169	166	169
Prill	378	323	278	217	189	167	170	171

Maj	379	312	271	213	192	167	170	171
Qershor	379	310	255	209	194	166	173	175
Korrik	367	308	248	211	196	166	174	172
Gusht	339	308	248	208	194	160	174	173
Shtator	333	294	244	205	191	159	175	171
Tetor	332	286	241	199	172	152	165	175
Nentor	331	291	242	202	166	155	165	173
Dhjetor	331	293	239	202	165	161	166	174

Harta e shperndarjes se bizneseve ne Bashkine Shijak

Aktualisht ne rajonin e Shijakut ka nje interes te larte per ndertime me perdorim biznesi dhe industri te lehte. Shume nga ndertimet ne pjesen qendrore te rajonit jane ne perdorim nga biznese si: magazinim dhe shitje me shumice, perpunim lekure, perpunim druri, perpunim materiale ndertimi, prodhime te ndryshme ne punishte.

Kostoja mesatare e njesive te banimit

Kostoja e nje njesie banimi varion sipas vendit ku eshte ndertuar dhe nivelit te rifiniturave. Materialet e perdorura per ndertim gjithsesi nuk variojne ndjeshem: banesat me kosto te ulet dhe ato te shtrenjta perdorin te njeitin material baze, qe eshte betonarmeja. Ndersa cilesia e ndertimit ndryshon dukshem duke qene se shumica dermuese e banesave jane ndertuar me forca te veta per te reduktuar keshtu kostot dhe duke dhene nje game te gjere te cilesive te ndertimit qe rrjedh nga aplikimi i ndryshem i teknologjise. Nje njesi e re banimi kushton mesatarisht 250-350 €/m².

Analiza e te ardhurave dhe shpenzimeve

Analiza do te behet duke patur parasysh keto kritere:

- te ardhurat mesatare mujore te familjes,
- perqindja e ketyre grupeve te te ardhurave ne te gjithe grupin e percaktuar te shoqerise,
- shpenzimet mesatare mujore te familjes,
- shpenzimet baze mujore te familjes

Rezultati i pare nga kjo tabele eshte qe klasa e varfer dhe shume e varfer e Shijakut perben rreth 30-35% te gjithe popullsisë, nderkohe qe klasa e mesme mbulon rreth 50% te popullsisë.

Megjithese ne Bashkine Shijak trajtohen rreth 50 familje me ndihme sociale, jane rreth 300 familje te tjera qe i trajton Bashkia me ndihme ekonomike.

Nje tjeter shtrese me te ardhura te paketa jane te ardhurit pas viteve 90. Pervet fakit qe kane ardhur nga zona te largeta e procesi i integritet eshte shpesh i veshtire.

Nje grup i marginalizuar jane pjesetaret e komunitetit Rom. Kjo shtrese eshte akoma me e veshtire te evidentohet dhe ndihmohet, per faktin qe edhe nuk kane vendbanime te perhereshme.

Informaliteti eshte nje element qe veshtireson klasifikimin real te situates, si per institucionin e Bashkise Shijak edhe per mbledhjen e te dhenave nga ana e grupit te punes. Vleresimi i te ardhurave mujore te kategorive te ndryshme eshte bere me afersi, ne kontakt me punonjesit e bashkise, pasi ne menyre zyrtare nuk ka informacion per keto te ardhura.

Arsimi

Sistemi arsimor i qytetit të Shijakut përbëhet nga objektet arsimore në vijim

Lloji i objektit arsimor	Nxenes/Femije	Vajza	Djem	Nr. i mesueseve/ Edukatoreve
Gjimnazi “16 shtatori”	507	309	198	23
Shkolla 8-vjecare “M. Dollaku”	388	189	199	22
Shkolla 8-vjecare “P. Llaftiu”	328	144	184	20
Shkolla 8-vjecare “Lidhja e Prizrenit”				
Kopshti Nr. 1	122	65	57	9
Kopshti Nr.2	190	85	105	11

Problem prej kohësh ka qenë degradimi i ambienteve sportive në shkollë dhe përvetësimi i sipërfaqeve të oborreve të shkollave nga ish-pronarë apo persona të ndikuar nga etja për fitim. Stabilizimi i sipërfaqeve ekzistuese dhe, atëherë ku është e mundur, rikthimi i pronës shkollave, është një nga prioritetet e pushtetit lokal aktual.

Sherbimi shëndetësor

Në qytetin e Shijakut ekziston një qendër shëndetësore. Qendra shëndetësore është rikonstruktuar plotësisht në nivel bashkëkohor me hapsira mjaft të pershtatshme për pacientin si brenda ashtu dhe jashtë saj.

Kjo qendër shërben gjithashtu edhe për komunat fqinje të Bashkisë së Shijakut, Xhafzotaj, Sukth, Maminas dhe Gjepale.

Institucioni	Nr. i qendrave shëndetësore	Nr. i personelit	Cfare përfshin shërbimi
Qendra shëndetësore Shijak	1	49	Sherbim përgjithësisht
Sherbim shëndetësor privat	—	—	—

Duke bërë pjesë të PPV-së kësaj objekte, rajoni do të mundësojë krijimin dhe sigurimin e zonave dhe vendeve për punësim. Në këtë mënyrë, do të ketë me shumë mundësi për të investuar, me shumë kompani dhe industri që do të zhvillohen në zonë, duke bërë me të real zbatimin e Planit dhe lidhjen e tij me situatën ekonomike aktuale.

Punësimi dhe burimet njerëzore

E përveç kësaj, në hapësirën e hapsirës Tiranë-Durrës, mund të theksojmë se ka disa faktorë të rëndësishëm përgjithësisht dhe që ndikojnë në mënyrë të drejtperdrejtë në zhvillimin e Bashkisë së Shijakut si dhe faktorë me pak të rëndësishëm për perspektivën e rajonit.

Rritja e shpejte e popullsisë ndikon në mbajtjen e gjendjes së papunesisë në nivele të qendrueshme. Banoret janë të prirur të punojnë në ndërtim. Ndërtimi i banesave dhe objekteve të tjera është kthyer në një biznes mbizotërues të ekonomisë së rajonit dhe ka një peshe të konsiderueshme në ekonominë lokale. Ky sektor i ekonomisë është i rëndësishëm për punësimin e popullsisë aktive. Si në shumë sektore dhe zona të Shqipërisë, informaliteti është një faktor i rëndësishëm në situatën ekonomike të zonës. Në aspektin ekonomik, zhvillimi i Bashkisë Shijak nënkupton berjen atraktive të kësaj zone për vende të reja pune, jo vetëm për grupmoshën aktive të banorëve të saj por dhe të fuqisë punëtore të ardhur zonat përreth. Kjo do të ndikojë në përfshirjen e Bashkisë së Shijakut në interesat zhvillimi përtej kufirit të saj lokal.

Papunesia në qytetin e Shijakut arrin në 10 %. Shkaku kryesor për këtë shifër në papunesinë është mbyllja e fabrikave pas viteve '90. Pjesa më e madhe e personave të papunë është mbi 40 vjeç si dhe të pakualifikuar. Papunesia është çështje si një problem mjafit i madh për komunitetin kjo sipas një vërtetimi të kryer në vitin 2007 ku papunesia ishte problem më i madh për qytetaret. Më poshtë na shfaqet tabela e cila është bazuar në anketimin të kryer nga organizatat jo fitimprurëse

Kapitulli 9 : Demografia

Popullsia

Shijaku ka një popullsi prej 15000 banorësh. Nga statistikat del që popullsia e Shijakut nga viti 2003-2007 ka një rritje mesatare të popullsisë prej 1% në vit dhe kjo rritje vjen si pasojë e ardhjes së familjeve të reja nga veri i vendit apo nga zonat rurale në afërsi të Bashkisë së Shijakut. Ndërsa rritja demografike natyrale e popullsisë ka ardhur në ulje nga viti 2003-2007 me pothuajse më 60%.

VITI	NR. TOTAL	BURRA	GRA	LINDJE	VDEKJE	NR. FAMILJEVE
2008	12299	6498	6395	94	67	4375
2009	12902	6509	6393	76	65	4381
2010	13046	6551	6495	82	61	4402
2011	13052	6560	6496	110	64	4404
2012	13059	6562	6497	165	68	4405

Levizja hapësirë e popullsisë karakterizohet nga dy forma tradicionale të saj: migracioni i brendshëm dhe emigracioni jashtë kufinjve të vendit. Kjo lëvizje e popullsisë dhe të gjitha hapat e zhvillimit ekonomik të zonës me ulje - ngritjet e saj, janë reflektuar dhe në punësimin e familjeve me grup-moshë aktive. Në këta grafike janë treguar parashikimet e rritjes së popullsisë, duke parë rritjen në këto katër-pesë vitet e fundit, dhe duke supozuar zhvillim me të njëjtin ritëm. Në këto vite zhvillimi nuk ka patur ritme galopante apo të ndikuara nga elemente apo situata të jashtëzakonshme, kështu që mund të konsiderohen si model për rritjen në vitet në vazhdim.

Densiteti i popullsisë

Banimi ne Bashkine Shijak ka vecorite e nje njesie demografike ne zhvillim. Ai kryesisht eshte rritur si nevoje e lindjes dhe zhvillimit te Bashkise. Lagjia Popullore dhe Lagjia Koder mbajne perqindjen kryesore te ndertimeve te banimit dhe perqendrimin me te madh te banoreve ne rajon. Banesat e ndertuara ne keto lagje jane relativisht te reja dhe nuk perbejne kushtezim ne ruajtjen e tyre per shkak te vlerave monumentale. Ndertimet ne zone jane aktualisht te perqendruara ne qender duke u shkrire lehte drejt periferise nga pikepamja e dendesise, kurse per nga numri i kateve nuk ka diferenca te dukshme. Popullsia eshte e shperndare ne te gjithe lagjet e bashkise, ndersa dendesia rezulton 5000 banore/km².

Vleresimi i kerkesave sasiore

Analiza e sasise se banesave te nevojshme synon te identifikojë numrin e perafert te shtepive qe duhet te ndertohen, si dhe te rrise stokun ekzistues te shtepive.

Per kete qellim jane marre ne konsiderate parametrat e meposhtem:

- Norma e siperfaqes se banimit/person dhe shkalla e formimit te familjeve te reja;
- Numrin e njesive qe kerkohen per te zbutur mbi-popullimin;
- Banesat qe mungojne;
- Zevendesimi i njesive ekzistuese te cilat do te amortizohen plotesisht gjate periudhes se planifikimit;
- Zevendesimin e njesive te demtuara ri-ndertimi i te cilave nuk eshte ekonomikisht i leverdisshem;

Si rezultat mbi bazen e te dhenave te mbledhura dhe tendencave te rritjes, dalin keto supozime:

- Bashkia Shijak do te arrije nje popullsi prej rreth 20000 banore deri ne vitet 2020, nese ritmi i rritjes ngelet po ai.
- Mesataria aktuale eshte 0.9 njesi familjare/banese, 1.5 njesi banimi/ familje dhe 57.1 m² siperfaqe banimi/banor. Keto do te ulen relativisht ne vitet e ardhshem, por nuk do te ndikojne ndjeshem ne nevojen per banesa;
- Rreth 400-500 njesi te reja banimi nevojiten per sistemimin e familjeve te reja, duke menduar vazhdimesine e koeficientit prej 1 familje/banese qe ka Bashkia aktualisht dhe kushtet aktuale te banimit (57.1 m²/banor);
- Rreth 300 banesa te reja nevojiten per banim, nese modifikohet lehte siperfaqja e banimit per person ne 35-40 m²/banor (vleresim propabilitar pergjithesues);
- Pothuajse cdo familje sot ka aktualisht nje banese;
- Mesatarisht, mendojme se sasia reale per njesi te reja banimi si rrezultat i rritjes do jete diku midis nevojës duke ruajtur koeficientet ekzistues dhe vleresimit propabilitar, qe parashikon modifikimin e ketyre koeficienteve, duke parashikuar edhe nje ritem me te disiplinuar te zhvillimit, pra rreth 350-400 njesi banimi;
- Rreth 10%, pra 200-220 ndertesa banimi do te amortizohen krejtesisht gjate periudhes se planifikuar;
- Rreth 20%, pra 400-450 ndertesa banimi do te kene nevoje per rinovim gjate periudhes se planifikuar;
- Rreth 200.000 m² banim shtese do jene te nevojshem deri ne vitin 2032 (4000 banore, 50 m²/banore);

Duke e permblodhur:

- Rreth 200 njesi te reja banimi nevojiten te ndertohen ne Shijak deri ne vitin 2020 dhe rreth 300-400 njesi te tjera deri ne vitin 2030;
 - Rreth 200 njesi ndertimi per shkak te zhvillimit ekonomik deri ne vitin 2020;
- Kjo i korrespondon nje ekuivalenti te rritjes se popullsise me rreth 3900-4000 banore.

Kapitulli 10 : Strehimi

Ligji 9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, i ndryshuar me ligjin nr. 9719, date 23.4.2007, specifikon në detaje kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të zgjedhura vendore të bashkive, në funksion të strehimit social. Përmendim se strehimi social është një funksion i pushtetit vendor, sipas përcaktimit të ligjit organik të pushtetit vendor nr.8652, datë 31.7.2000.

Më poshtë po rendisim dispozitat e ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004 që i referohen dhe japin kompetenca, apo ngarkojnë me detyrime organet e bashkive:

- ÷ Neni 4 pika 2 e ligjit, ngarkon organet e qeverisjes vendore për administrimin e kërkesave për programet sociale të strehimit dhe, përcaktimin e përparësive dmth. të atyre familjeve/individëve që trajtohen me strehim social me përparësi.
- ÷ Neni 7 i ligjit i ngarkon bashkitë me detyrimin për të parashikuar, në territoret nën juridiksionin e tyre, sipërfaqe truall për ndertimin e banesave sociale me qira.
- ÷ Neni 8 i ligjit, parashikon kompetencën e këshillit bashkiak për blerjen e banesave në tregun privat, në ato raste kur kjo është më e leverdisshme sesa ndertimi i banesave sociale me qira.
- ÷ Neni 9 i ligjit, i jep kompetencë këshillit bashkiak për të përcaktuar mënyrat e administrimit dhe mirëmbajtjes së banesave sociale me qira.
- ÷ Neni 11 i ligjit, ngarkon këshillin bashkiak për të miratuar, çdo vit, masën e qirasë vjetore, për banesat sociale me qira.
- ÷ Neni 14 i ligjit, parashikon kompetencën e këshillit bashkiak për të miratuar dhenien e “bonusit të strehimit”.
- ÷ Neni 18 i ligjit, ngarkon zyrën e strehimit në bashki për administrimin e kërkesave për banesa me kosto të ulët.
- ÷ Neni 19 i ligjit, ngarkon këshillin bashkiak për të përcaktuar kufirin minimal dhe maksimal të të adhurave të familjeve që përfitojnë banesa me kosto të ulët, sipas formulës së dhënë nga ligji, në aneksin “C”.
- ÷ Neni 21 i ligjit, ngarkon zyrën përkatëse në bashki për të bërë pajisjen e truallit me infrastrukturën e nevojshme për ndertimin e banesave.
- ÷ Neni 22, pika 1, parashikon kompetencën e këshillit bashkiak për të miratuar çmimin e shitjes së truallit të pajisur me infrastrukturë.
- ÷ Neni 22, pika 5, parashikon detyrimin e bashkive për të financuar dhe menaxhuar programet e pajisjes së truallit me infrastrukturë.
- ÷ Neni 24, pika 3 e ligjit, ngarkon bashkitë me financimin e subvencionit të qirasë nga të ardhurat e veta për familjet që nuk plotësojnë të ardhurat e mjaftueshme. Subvencioni i qirasë miratohet nga këshilli bashkiak.
- ÷ Neni 26 i ligjit, ngarkon bashkitë për të paguar punonjës të specializuar që ofrojnë asistencë teknike për familjet që përfitojnë truall të pajisur me infrastrukturë.

- ÷ Neni 28 i ligjit, i jep kompetencë nëpunësve të zyrës së ndihmës ekonomike në bashki për të verifikuar gjendjen ekonomike dhe financiare të familjeve që përfitojnë ndihmë shtetërore.
- ÷ Neni 29 i ligjit, i jep kompetencë këshillit bashkiak për të shqyrtuar ankesat e familjeve në lidhje me rezultatet e verifikimit të gjendjes ekonomike të tyre të kryera nga nëpunësit e bashkisë.
- ÷ Neni 30 i ligjit, parashikon burimet e financimit të programeve sociale të strehimit që financohen, midis të tjerash, nga të ardhurat e bashkisë me burime të veta dhe të ardhurat nga shitja e truallit të pajisur me infrastrukturë.
- ÷ Neni 31 i ligjit, parashikon detyrimin e rendësishëm për bashkitë për të hartuar programet 10 vjeçare të strehimit.
- ÷ Neni 35 i ligjit përmbledh funksionet e bashkive për zbatimin e ligjit të cilat po i rendisim më poshtë në mënyrë të plotë, ku përcaktohet që bashkitë kanë detyrë të:
 - ÷ identifikojnë nevojat për strehim, sipas programeve të hartuara në bazë të këtij ligji, për popullsinë nën juridiksionin territorial të tyre;
 - ÷ hartojnë programe 10-vjeçare për strehimin dhe projekte trevjeçare, bazuar në burimet financiare që zotërojnë;
 - ÷ sigurojnë sheshet e ndërtimit dhe pajisjen e truallit me infrastrukturë, në zbatim të programeve të strehimit, të hartuara në bazë të këtij ligji;
 - ÷ paraqesin kërkesat pranë ministrit që mbulon fushën e strehimit, për financime, investime dhe subvencione, sipas këtij ligji;
 - ÷ krijojnë dhe administrojnë, në nivel vendor, bazën e të dhënave për familjet që përfitojnë strehim, sipas këtij ligji;
 - ÷ përcaktojnë kostot maksimale të lejueshme, brenda kufijve të përcaktuar nga ministri që mbulon fushën e strehimit, për ndërtimin e banesave, sipas këtij ligji;
 - ÷ sigurojnë ndërtimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale me qira;
 - ÷ njoftojnë çdo vit ministrin që mbulon fushën e strehimit, për ecurinë e programeve të strehimit, sipas këtij ligji;
 - ÷ kryejnë të gjitha funksionet e tjera të parashikuara në këtë ligj.

Nuk ka të dhëna të detajuara dhe të verifikuara për nevojat për strehim social në të gjithë territorin e Bashkisë Shijak. Një e dhënë dytësore, por e kontestueshme përfitohet nga një listë paraprake e hartuar rreth 3 vite më parë (2012) kur bashkia Shijak bëri një përpjekje për ndihmë përmes kredive me kushte të favorshme duke regjistruar përmes vetë-deklarimit personat në nevojë për strehim. Sipas kësaj të dhëne nr i familjeve të regjistruara gjatë fushatës së vitit 2012 ishte rreth i konsiderueshëm duke konsideruar territorin e mëparshëm të Bashkisë Shijak. Sipas nëpunësve të zyrës së urbanistikës, besohet se ky numër, deri në dhjetor 2015, të ishte më i vogël, rreth 100 familje. Ndërsa periodikisht në kushte të vështira strehimi në territorin aktual të Bashkisë kanë qënë banorë dhe/ose shtegtarë të popullsisë rome. Për këtë grup popullsie, nisur nga nevojat urgjente dhe burimet e kufizuara, Bashkia ka aplikuar zgjidhje te përkohëshme duke përshtatur si banesa, ndërtesa publike që ajo i ka në zotërim, përdorim.

Megjithatë në situatën aktuale, pas përmbytjeve të shkatuara nga vërshimi i lumit Erzen në fillim të Janarit 2016, nr i familjeve në kushte vështira dhe/ose të papranueshme për strehim është rritur si rezultat i kësaj situatë. Pritet që përmes ndërhyrjeve të qeverisë vendore dhe asaj qëndrore situata të përmirësohet megjithatë sipas banorëve dhe nëpunësve të bashkisë pasojat e përmbytjes do të kërkojnë kohë të riparohen.

Kapitulli 11 : Infrastruktura

Infrastruktura, shërbimet dhe transporti

Infrastruktura e Bashkisë Shijak

Infrastruktura e Bashkisë Shijak përfshin shërbimet e mëposhtme.

- Furnizimi me ujë
- Largimi i ujrave të zeza dhe depozitimi
- Drenazimi i ujrave të bardha
- Furnizimi me energji elektrike
- Shërbimi telefonik

Shërbime të tjera, si ngrohja, shpërndarja e gazit, etj, nuk ekzistojnë dhe prandaj nuk janë futur në listën e mësipërme. Duhet të themi që asnjë nga shërbimet e mësipërme nuk sigurohet direkt nga Bashkia, por nga kompanitë që kryejnë shërbimet ndaj të cilave Bashkia ka influencën e vet në shkallë të ndryshme. Duhet të kihet parasysh gjithashtu edhe fakti, që departamentet e shërbimeve publike në Bashki janë të kufizuara me departamentin e shërbimeve (ose punët publike) që përfshijnë sektorët e mëposhtëm: trafikun dhe transportin, pastrim-gjelberim dhe ndricim-dekor i Bashkisë

Uji i pijshëm, kanalizimet dhe ujrat e shiut; këto shërbime janë nën përgjegjësinë e ndërmarrjes së ujesjellës kanalizimeve. Pronësia e kësaj ndërmarrjeje, që është e ndërtuar si sh.a., Kontrolli mbi kompaninë ushtrohet nga bordi mbikqyres i përbërë nga përfaqësues të Bashkisë Shijak. Nga ana financiare dhe ajo e zhvillimit kompania është e pavarur.

Kompania është në vështirësi financiare për shkak të mospagueses së faturave të konsumit sa që nuk është në gjendje të bëjë investime dhe investimet e mëdha për rinovim apo zgjerim behen vetëm me fonde të qeverisë ose të donatorëve të huaj.

Shijaku ka rritje të kërkesave për ujë të pijshëm si rezultat i shtimit të popullsisë dhe rritjes së standartit të cilësive të jetes. Ka probleme me lidhjet e jashtëligjshme, shpërdorimin e ujit të pijshëm, mbledhjen e pamjaftueshme të detyrimeve etj.

Rrjeti i kanalizimeve të Bashkisë Shijak.

Në Bashkinë Shijak, rrjeti ka përfunduar vetëm në disa zona. Për pjesë tjetër ra punohet me gropa septike familjare dhe jo kolektive. Pastrimin e të cilave e bëjnë vetë familjarët. Si dhe evidentohen disa shkarkime të parregullta në lumin Erzen.

Shërbimet telefonike kanë qenë prone e Telekomit Shqiptar i cili, gjithashtu është privatizuar tashmë. Vitet e fundit janë dhënë licenca të reja për operatorë të rinj telefonike, por aktiviteti i tyre është i kufizuar brenda kryeqytetit ose në disa bashki të vogla. Në Bashkinë Shijak është një zyrë postare, e cila ndodhet në zonën e qendrës. Përsa i përket telefonave fikse, lidhja është realizuar nepermjet Alb telecom i cili ka përmirësuar rrjetin e

shperndarjes si dhe nga subjete te ndryshem local qe jane licensuar per te fruar kete sherbim .Po ashtu dhe lidhja e internetit ofrohet nga ket subjekte . Sherbimi I telefonise se levishme pfrohet nga te gjithë operatorët komtare te licensuar.

Mbetjet urbane qe 15000 banoret e Bashkise Shijak prodhojne cdo dite, vleresohen ne masen rreth 30 ton, ose 0.5 kg/mbeturina per banor.Mbeturinat e ngurta perbehen nga mbetjet komunare (inerte, skeletike, bimore),mbeturinat e tregjeve, dhe mbeturinat industriale. Ne situaten aktuale funksionojne pikat e grumbullimit te mbeturinave dhe, me vendim te Bashkise , vendi i grumbullimit te mbeturinave te perkoheshme eshte I percaktuar dhe me pas ato transkerohen per ne venddepozitimin e mbeturinave rajonal te Durrësit. Gjithashtu vihet re nje numir I vogel venddepozitimesh te perkohshme dhe disa pika ku mbetjet jane hedhur pa kriter.

Energjia elektrike

Shperndarja e energjise elektrike ka qene pergjegjesi e ndermarrjes kombetare elektrike KESH, qe ishte ngarkuar me prodhimin dhe shperndarjen e energjise elektrike. Sidoqofte ne vitin 2008, pjesa e shperndarjes u shnderrua ne nje entitet te vecante dhe ju dorezua nje koncesionari te quajtur OSSH. Nuk ka ndonje informacion per menyren se si te drejtat dhe nevojat e Bashkise perfaqesohen ne kontraten e koncesionit.

Furnizimi me energji elektrike behet nga rrjeti kryesor nacional dhe kur hyn ne skemen lokale, mbizoterohet nga nje rritje e ndjeshme e perdorimit. Lidhjet e jashteligjeshme jane nje problem shqetesues, por po punohet intensivisht per eliminimin e tyre, si dhe per grumbullimin e detyrimeve te konsumatoreve. I gjithë rrjeti ka nevojë per nderhyrje, me qellim rritjen e seksionit te percjellesit

Infrastruktura rrugore

Levizja e transportit dhe struktura e rrjetit rrugor ze nje peshe te konsiderueshme ne zhvillimin e jetes sociale dhe ekonomike te Bashkise Shijak. Shijaku ka 37 rruge si dhe 2 sheshe publike. Ne total jane rreth 10455 metra linear rruge, nga te cilat 5740 jane te shtruara me asfalt dhe 4715 nuk jane.

Transporti publik

Duke pare madhesine e qytetit te Shijakut, nuk eshte e konsideruar si e nevojshme qe ne qytet te ofrohet transport publik Brenda qytetit. Ne keto rrethana Bashkia ka licensuar 3 firma private per ofrimin e transportit publik te qytetareve te Shijakut me Durrësin, Tiranen dhe Shetelin.

1. Shijak - Durrës – Shijak Kompania transportuese posedon 15 autobuse qe mundeson transportimin e qytetareve. Nisja behet cdo 30 minuta. Frekuenca e transportit është vendosur në çdo 30 minuta .

2. Shijak - Tiranë – Shijak Kompania posedon 5 autobuse.

3. Shijak - Shetel – Shijak Ndersa per kete aks kompania zoteron 1 autobus.

Sigurimi i transportit publik, permendur me lart lehteson qarkullimin e lire te qytetareve ne zonat kryesore te komunikimit ne vend. Gjithashtu Bashkia ka licensuar edhe 3 mjete te tjera taksi deri ne 4 persona si dhe 12 furgona te afte per te transportuar deri ne 8

persona. Keto automjeta mund te veprojnë në të gjithë territorin e Shqipërisë në varësi të nevojave të qytetareve.

Shijaku ka një pozitive gjeografike mjaft të favorshme për shkak të afërsisë me kryeqytetin e vendit Tiranën (38km), me aeroportin ndërkombëtar të Rinasit (vetëm 28km), me portin kryesor të Shqipërisë, atij të Durrësit (11km). Lidhja me e afërt e qytetit me sistemin hekurudhor është ai i Durrësit, pra 11 km.

Kjo pozitive mjaft e favorshme si dhe me përmirsimin e rrugëve bën të mundur që një qytetar në Shijak të udhetojë për në Tiranë vetëm për 25 minuta, në Durrës 10 minuta dhe në aeroportin ndërkombëtar “Nënë Tereza” për rreth 20 min. Gjithmone në kushte të favorshme të trafikut.

Kapitulli 12 : Analiza e pronave publike

Tabela e mëposhtme e integruar në Vendimin Nr.839, datë 22.7.2009 ‘Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shijak të qarkut të Durrësit’ paraqet të drejtat dhe kufizimet e pronësisë mbi hapësirat dhe objektet publike që ndodhen në territorin e qytetit të Shijakut.

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-7	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	NË PRONËSI
8,9,104,105	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	NË PRONËSI
15-17	Varrezat publike	NË PRONËSI
40-43, 45 (VETËM TROJET)	Infrastrukturë (troje të lira)	NË PËRDORIM
18-39, 44 40-43, 45 (VETËM SHESHET) 46-49	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	NË PRONËSI
50-53	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	NË PRONËSI
54-65	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile.	NË PRONËSI
97,98	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	NË PËRDORIM
96,99	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive).	NË PRONËSI

Tabela e mëposhtme e integruar në Vendimin Nr.44, datë 19.1.2011 Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Xhafzotaj të qarkut të Durrësit’ paraqet të drejtat dhe kufizimet e pronësisë mbi hapësirat dhe objektet publike që ndodhen në Bashkinë e Shijakut, përkatësisht territorin e njësisë administrative Xhafzotaj.

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-9	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
13-21, 153	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
10-12	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
22-31, 154	Varrezat publike	Në pronësi
51	Infrastrukturë (troje të lira)	Në përdorim
32, 44-50	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
102	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social	Në pronësi
52-59	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
68-73, 75, 76, 78, 79, 83, 86, 87, 91, 95, 99, 100, 155	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive). Prona 155 është tokë arë.	Në pronësi

Tabela e mëposhtme e integruar në Vendimin Nr.165, datë 13.2.2008 ‘Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Maminas të qarkut të Durrësit’ paraqet të drejtat e pronësisë mbi hapësirat dhe objektet publike që ndodhen në Bashkinë e Shijakut, përkatësisht territorin e njësisë administrative Maminas.

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-12	Prona që përdoren për realizimin e programeve	Në pronësi
13-20	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
28-30	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social- kulturore e sportive	Në pronësi
31-55	Varrezat publike	Në pronësi
56	Prona që përdoren për mbrojtjen civile	Në pronësi
85	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka	Në përdorim
96	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi

57-66,86 (vetëm rrjeti terciar)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive)	Në pronësi
83	Kanalizime të ujërave të zeza	Në pronësi
93-94	Sheshe publike	Në pronësi
95	Infrastrukturë (troje)	Në përdorim
87-92	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi

Tabela e mëposhtme e integruar në Vendimin Nr.173, datë 13.2.2008 'Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Gjepalaj të qarkut të Durrësit', paraqet të drejtat dhe kufizimet e pronësisë mbi hapësirat dhe objektet publike që ndodhen në Bashkinë e Shijakut, përkatësisht territorin e njësisë administrative Maminas.

FORMULARE PER TRANSFERIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHITETERORE
(Sipas inventarizimit te pronave te vecanta te tipit,Pyje,Kullota,Livadhe,Shkembore etj)

Institucioni i Pushtetit Qendror: M.M.P.A.U

Komuna Gjepalaj

Nr. Rendor	Nr. i pronës sipas VKM	Emertesa e Ekonomisë Pyjore dhe Kullorore (EPK) Shtrirja Gjeografike e EPK	Emertesa e Ngjësve nd. ndodhja (sipas emertes popullore)	Numeri i Ngjësve	Destinacioni	Sipërfaqja në ha	Funksioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni/ Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/ Enti Përdorues Statusi juridik i përdorimit	Te dhëna të tjera (Shënime të vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	58	Komuna Gjepalaj Fshati Hardhishtë	Gjomi rremillevë	144	Pyll prodhues	10	Lende dru zjarri	M.M.P.A.U	D.R.P-K Dures	
2	58	Komuna Gjepalaj Fshati Hardhishtë	Gjomi rremillevë	145	Pyll prodhues	3.25	Lende dru zjarri	M.M.P.A.U	D.R.P-K Dures	
3	57	Komuna Gjepalaj Fshati Hardhishtë	Gjomi kokomajve	15	Pyll prodhues	7.5	Lende dru zjarri	M.M.P.A.U	D.R.P-K Dures	
4	58	Shijak Maminas Fshati Shetel	Faqja e Shelgut	3	kullote	31.7	kullote fshati	M.M.P.A.U	D.R.P-K Dures	kullota komunaie me VKM nr. 700, dt. 23.10.95

Njësia e Qeverisjes Vendore Gjepalaj

Lidhja 1

Numrat rendore te pronave ne listen e inventarit	Fusha e përdorimit te pronës	Lloji i transferimit
55-57...	Pyll, Kullote	Pronesi

Kapitulli 13 : Analiza e marrëdhënieve të pronësisë mbi tokën

Sipas raportit të Bankës Botërore mbi qeverisjen në mbrojtjen e të drejtave mbi pronën e paluajtshme në Shqipëri (Qershor 2011), të drejtat mbi pronën në Shqipëri nuk janë mjaftueshmërisht të sigurta dhe përbëjnë një sfidë të rëndësishme ndaj qeverisjes. Problemet kanë dalë nga regjistrimi fillestar i paplotë i titujve, mungesa e kartelave të sakta kadastrale dhe, në shumë raste, mungesa e informacionit provues të besueshëm për pronësinë.

Këto probleme janë të pranishme edhe në Bashkinë Shijak ku ende rregjistrimi i tokave është i papërditësuar dhe mungon harta kadastrale e plotë. Mbivendosjet e parcelave janë një tjetër problem i identifikuar në rregjistrimin e tokave në Shijak.

Po ashtu zhvendosja e popullsisë kryesisht nga zonat verilindore në Bashkinë e Shijakut dhe rrethinat e saj ka çuar në zënie e tokave në mënyrë informale. Kjo ka sjellë probleme në legalizimin e banesave të tyre dhe marrjen e titujve të ligjshëm të pronësisë për tokat. Proçesi i legalizimit ka ngelur pothuajse në vend për qytetin e Shijakut dhe Gjepalajn. Ndërsa në Zhafzotaj dhe Maminas proçesi i legalizimeve është pothuajse i përfunduar. Në disa raste banorët janë pajisur me aktin e marrjes së territorit në pronesi (AMTP) por nuk janë pajisur në realitet me tokë. Ndërkohë vazhdojnë kërkesat e shumta për rregjistrimin fillestar.

Mungesa e një titulli pronësie dhe niveli i informalitetit pengojnë banorët të kryejnë veprime në tregun formal të pronave ose ti përdorin ato si kolateral për kredi.

Situata nuk favorizon klimën e biznesit vendas dhe të huaj duke u bërë pengesë për investimet, veçanërisht për Shijakun i cili ndodhet përgjatë zonës industriale dhe i mirë barazlanguar nga dy qendrat më të mëdha të vendit. Një vërtetim i zhvilluar në vitin 2008, në kuadër të Vlerësimit të Klimës së Biznesit të kryer nga Banka Botërore, konstatonte se të drejtat e pasigurta mbi pronën dhe mbipërdorimin e tokës konsiderohen si pengesa “të rënda ose shumë të rënda” përkatësisht nga mbi 20% e firmave. Ky ndikim duket se është më i madh te firmat e vogla dhe të mesme, dhe informacionet gojore thonë se investitorët e huaj shpesh tërhiqen e nuk investojnë në Shqipëri, për shkak të vështirësive për përdorimin e tokës ose të objekteve, në mungesë të titujve të qartë.

Kapitulli 14 : Çështjet, zonat dhe/ose objektet e rëndësishme kombëtare

Pavarësisht vlerave të veçanta natyrore dhe të peisazhit në Bashkinë Shijak nuk ka ndonjë zonë të mbrojtur në nivel kombëtar si parqe kombëtare, monumente natyre, zona strikte, rezervate të mbrojtura etj. Po ashtu nuk ka specie të përfshira në listën e kuqe apo në rrezik zhdukjeje.

Megjithatë ndërthurja mes territorit kordinor me klimën e favorshme dhe burimet ujore si Lumi i Erzenit, rezervuaret e shumta dhe përrrenjtë janë potenciali i duhur për krijimin e parqeve natyrore për çlodhje dhe turizëm.

Ruajtja e elementeve karakteristike natyrorë si ullinjtë 300 vjeçarë apo Pema e Vishkullit në Bodinak (Maminas) janë një vlerë e shtuar e mjedisit natyror në Bashkinë e Shijakut.

Kapitulli 15 : Analiza e elementeve të rëndësishme territorial

Potencialet mjedisore që mbart Bashkia e Shijakut janë të lidhura me zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, industrisë e tregtimit dhe turizmit.

Pozicioni gjeografik i Shijakut mes dy qendrave më të rëndësishme të vendit siç janë Tirana dhe Durrësi, e bën atë një zonë me perspektivë të lartë zhvillimi ekonomik dhe social. Distanca e shkurtër nga këto dy qendra favorizon shkëmbimet tregtare kombëtare dhe ndërkombëtare. Vendosja e disa bizneseve industriale përgjatë autostradës përbën një potencial të lartë për krijimin e hapësirave magazinuese dhe tregtare si për produktet bujqësore e blektorale ashtu dhe për produktet industriale.

Zhvillimi i aktiviteteve bujqësore dhe blegtorale janë traditë e banorëve të zonës duke krijuar një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e agrobiznesit dhe ngritjen e fermave bujqësore dhe blegtorale. Territori kodrinor dhe klima e butë favorizon kultivimin e perimeve dhe foragjereve të ndryshme, vreshtave, pemtoreve dhe ullishteve.

Zhvillimi i turizmit dhe ekoturizmit janë një tjetër potencial i Bashkisë Shijak. Kodrat e buta, klima e përshtatshme mesdhetare dhe ushqimi tradicional vendas mund të shërbejnë për të tërhequr vëmendjen e turistëve vendas dhe të huaj. Kjo mund të bëhet nepermjet krijimit të hapësirave për panairë dhe promovimeve të produkteve dhe kulturës vendase. Gjithashtu, promovimi i peisazhit mund të nxitet me anë të ngritjes së disa pikave për vrojtimin panoramik të kodrave dhe mjedisit përreth.

Bashkia Shijak është e pasur me burime ujore si Lumi Erzen, rreth 14 rezervuare dhe dy përrenj. Këto burime duke u kombinuar dhe me mjedisin e këndshëm natyror që ofron zona janë një potencial për zhvillimin e turizmit dhe krijimin e parqeve natyrore për shplodhje.

Në Shijak nurrin e ditëve me diell është i lartë gjë që lejon futjen përdorimit të pajisjeve të energjiave të rinovueshme.

Cili nga çështjet më poshtë është më e rëndësishme për ju	Perqindja e grumbulluar	Perqindja	Perqindja vlefshme	Frekuenca
---	-------------------------	-----------	--------------------	-----------

1.Punesimi	92.2	32	32	144
2.Furnizimi me energji elektrike	40.2	30.2	30.2	136
3.Ruge te reja/Ruge per tu ndertuar	60.2	18	18	81
4.Edukimin me te mire/ Shkolla te reja	5.1	5.1	5.1	23
5.Largimi I mbeturinave	10	4.9	4.9	22
6.Strehim	95.3	3.1	3.1	13
7.Krimi	97.8	2.4	2.4	10
8. Te tjera	42.2	2	2	9
TOTALI	100.0	100.0	100.0	450

Kapitulli 16 : Analiza e elementeve përjashtues


Aktiviteti sizmik në bashkinë Shijak

Të dhënat historike për aktivitetin sizmik në bashkinë Shijak, ashtu si edhe për zonat përreth kësaj bashkie, janë relativisht të mangëta. Tërmeti më i fortë dhe me largësi epiqendrore më të vogël që ka goditur zonën është ai i datës 09.01.1988 me magnitudë të valëve sipërfaqësore Msç5.4 dhe intensitet loç7-8 ballë (MSK-64).

Rreziku sizmik për Bashkisë Shijak

Sipas hartës se meposhtme të rajonizimit sizmik te perpiluar ne fund te viteve ‘70, rajoni në të cilin ndodhet bashkisë Shijak përfshihet në një zonë ku mund të priten tërmete me intensitet loç7 ballë (sipas MSK-64) për kushte mesatare trualli.

Harta e intensiteteve sizmike sipas MSK 1964



Nga kjo harte, vihet re se shpejtimi maksimal reference per bashkisne Shijak eshte 0.267g.

Harta e shpejtimeve maksimale referencë në truall shkëmbor, për periudhë përsëritje 475 vjet, sipas botimit “Sizmiciteti, sizmotektonika dhe vlerësimi i rrezikut sizmik në Shqipëri” – 2010

Nisur nga aktiviteti sizmik historik, ndërtimi gjeologjik si dhe nga studimet e lartpermendura, mund të thuhet se Bashkia Shijak ndodhet në një zonë aktive ngapikëpamja sizmike.

Vulnerabiliteti i veprave të ndërtimit ekzistuese

Veprat e ndërtimit ekzistuese përbëhen kryesisht nga ndërtesa të ulëta, me lartësi deri në 2-3 kate dhe disa banesa kolektive 4-5 kate te ndertuara perpara viteve 90 di dhe 2-3 ndertesat me te larta se 5 kat te ndertuara 15 vitet e fundit. Ekzistojnë gjithashtu ndërtesa industriale të lehta, relativisht të pakta në numër, me strukturë metalike. Mbizotërojnë ndërtesat e ndërtuara përpara viteve '90, por ekzistojnë edhe ndërtesa të reja (kryesisht ndërtesa të lehta industriale).

Mund të thuhet se vulnerabiliteti i këtyre veprave të ndërtimit është i ulët, për shkak të lartësisë së ulët të tyre dhe materialeve të përdorura. Megjithatë, kushtet teknike të projektimit dhe të zbatimit që janë ende në fuqi në Shqipëri janë të vjetëruara. Studimet e shumta ndërkombetare kanë çuar drejt përmirësimit të vazhdueshëm të kodeve të projektimit, sidomos në drejtim të projektimit të strukturave rezistente ndaj tërmeteve. Shqipëria është futur në rrugën e adoptimit të Eurokodeve, si në kuadër të nismave ligjore, ashtu edhe në zbatimin në praktike të rekomandimeve të Eurokodeve. Në bashkë me adoptimin e kodeve bashkëkohore të projektimit, rritet edhe kërkesa sizmike për strukturat. Në këtë kuadër, një pjesë e ndërtesave ekzistuese, të projektuara sipas Kushteve Teknike të Projektimit (KTP) mund të kenë nevojë për trajtim të vecantë për të garantuar krenarinë e kushteve të projektimit rezistent ndaj tërmeteve. Në bazë të informacioneve paraprake, është konstatuar se një pjesë e ndërtimeve të reja në Bashkinë Shijak kanë të aplikuar koncepte të projektimit rezistent ndaj tërmetit dhe Eurokodeve nepërgjithësi.

Referuar rrezikut sizmik (që është i konsiderueshëm), vulnerabilitetit të veprave të ndërtimit ekzistuese (që është relativisht i ulët) si dhe shkallës së ekspozimit të këtyre veprave ndaj rreziqeve sizmike, mund të thuhet paraprakisht se risku sizmik nuk është i lartë. Megjithatë, shkalla e ekspozimit të strukturave ndaj rreziqeve sizmike ka ardhur duke u rritur, sidomos pas viteve '90 me rritjen e intensitetit të ndertimeve në zona të caktuara të Bashkisë Shijak.

Kapitulli 17 : Analiza e përdorimit ekzistues të tokës

Kapitulli 18 : Analiza e periferialitetit

Kapitulli 19 : Analiza e kushteve dhe cilësisë fizike të strukturave e të territoreve

Kapitulli 20 : Analiza e tipologjisë hapësinore ekzistuese